



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 49

Tiranë – E martë, 19 mars 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 135, datë 6.3.2024	Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave të kërkesës, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare kur Republika e Shqipërisë ka interes kombëtar apo interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës dhe sportit... 5521
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 141, datë 13.3.2024	Për emërim në detyrë..... 5529
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 143, datë 13.3.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 332, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i aksit rrugor Thumanë–Vorë–Kashar’”, të ndryshuar..... 5529
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 144, datë 13.3.2024	Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për dhënien e miratimit për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror..... 5543
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 145, datë 13.3.2024	Për lirimin nga detyra të prefektit të qarkut të Fierit..... 5550
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 146, datë 13.3.2024	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Vlorës..... 5550
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 13.3.2024	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar..... 5550
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 148, datë 13.3.2024	Për kriteret dhe procedurat për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e institucioneve të arsimit special në qendra burimore, si dhe për mënyrën e organizimit e të funksionimit të tyre 5555

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 149, datë 13.3.2024	Për përcaktimin e kriterëve të posaçme dhe procedurave për dhënien e statusit “Shkollë me status të veçantë”	5558
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 150, datë 13.3.2024	Për ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si autoritet kontraktor për realizimin e projektit “Kolegji i Evropës”	5560
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 13.3.2024	Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Thimjo Plaku.....	5561
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 13.3.2024	Për lirim dhe emërim në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit të Provës.....	5561
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 154, datë 13.3.2024	Për emërimin në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve.....	5562
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar nr. 93, datë 13.3.2024	Për delegim të përkohshëm të kompetencave	5562
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 15, datë 6.3.2024	Për një ndryshim në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”	5562
Urdhër i Komisionerëve Publikë nr. 27, datë 12.3.2024	Për shfuqizimin e kompetencave të deleguara.....	5563
Urdhër i Komisionerëve Publikë nr. 28, datë 12.3.2024	Për delegim kompetencash.....	5563



VENDIM

Nr. 135, datë 6.3.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
PROCEDURAVE TË KËRKESËS, TË
RREGULLAVE TË KRYERJES SË
VERIFIKIMEVE DHE KONTROLLEVE
TË NEVOJSHME PËR FITIMIN E
SHTETËSISË SHQIPTARE KUR
REPUBLIKA E SHQIPËRISË KA INTERES
KOMBËTAR APO INTERES NË FUSHËN
E ARSIMIT, SHKENCËS, ARTIT,
KULTURËS DHE SPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**KREU I
PËRKUFIZIME**

1. Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Program i veçantë i shtetësisë në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit”, tërësia e dispozitave normative, e kriterëve teknike, mbi bazën e të cilave një kontribut i një shtetasi të huaj në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit do të vlerësohet si kontribut me interes kombëtar për shtetin shqiptar dhe me anë të të cilit mund të fitohet shtetësia shqiptare;

b) “Program i veçantë i shtetësisë në fushën e artit dhe kulturës”, tërësia e dispozitave normative, e kriterëve teknike, kulturore dhe artistike, mbi bazën e të cilave një kontribut i një shtetasi të huaj do të vlerësohet si kontribut me interes në fushën e artit e të kulturës për shtetin shqiptar dhe me anë të të cilit mund të fitohet shtetësia shqiptare;

c) “Program i veçantë i shtetësisë në fushën e interesit kombëtar”, tërësia e dispozitave normative, mbi bazën e të cilave do të vlerësohet kontributi i një shtetasi të huaj me interes kombëtar për shtetin shqiptar dhe me anë të të cilit mund të fitohet shtetësia shqiptare;

ç) “Kërkesë për fitimin e shtetësisë shqiptare”, kërkesa e paraqitur nga kërkuesi për fitimin e shtetësisë, vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi me prokurë, në bazë të formatit sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

d) “Kërkues”, çdo shtetas i huaj, i cili plotëson kriteret teknike dhe kërkon për fitimin e shtetësisë shqiptare, sipas programeve të veçanta në fushat e arsimit, shkencës, sportit, artit apo kulturës;

dh) “Vlerësim kontributi”, shkresa e arsyetuar, me anë të së cilës ministria përgjegjëse për arsimin, shkencën dhe sportin ose artin dhe kulturën vlerëson kontributin e kërkuarit për t’u bërë pjesë e programeve të veçanta të shtetësisë.

KREU II

**KRITERET PËR FITIMIN E SHTETËSISË
SHQIPTARE NË BAZË TË PROGRAMEVE
TË VEÇANTA TË SHTETËSISË ME
INTERES NË FUSHËN E ARSIMIT,
SHKENCËS, ARTIT, KULTURËS
DHE SPORTIT**

Ka të drejtë të kërkojë për t’u përfshirë në programin e veçantë shtetasi i huaj (në vijim kërkuesi), që plotëson këto kriterë:

1. Ka mbushur moshën 18 vjeç;

2. Ka zotësi për të vepruar;

3. Nuk ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në shtetin e vet, në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet të tretë për vepra penale, për të cilat ligji shqiptar parashikon dënime me jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie. Përfshirë nga ky rregull bëhet vetëm në ato raste kur vërtetohet se dënimi është dhënë për motive politike;

4. Nuk përbën kërcënim për sigurinë kombëtare dhe rendin publik të Republikës së Shqipërisë;

5. Nuk rezulton i regjistruar si person me rekorde kriminale në listat e organizatave ndërkombëtare, partnere të sigurisë;

6. Deklaron se do të banojë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të paktën 3 (tre) muaj gjatë 5 (pesë) vjetëve nga miratimi i kërkesës;

7. Ka kontribut të veçantë në fushat e arsimit, shkencës, artit, kulturës dhe sportit;



8. Nuk është subjekt i masave shtrënguese ndërkombëtare, të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

KREU III

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR FORMËN DHE PARAQITJEN E KËRKESËS PËR FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE NË BAZË TË PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË SHTETËSISË NË FUSHËN E ARSIMIT, SHKENCËS, ARTIT, KULTURËS DHE SPORTIT

1. Kërkesa për fitimin e shtetësisë shqiptare, në bazë të programeve të veçanta të shtetësisë, bëhet në bazë të formatit të kërkesës, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet të këtij vendimi.

2. Dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer me deklaratën e nënshkruar të përkthyesit zyrtar ose me vërtetim nga noteri.

3. Kërkesa për përfshirjen në programet e veçanta të shtetësisë paraqitet në Agjencinë për Hartimin e Programeve të Veçanta të Shtetësisë (në vijim “AHPVSH”) nga vetë kërkuuesi ose përfaqësuesi me prokurë.

4. Në çdo rast, kërkesa për fitimin e shtetësisë në bazë të programeve të veçanta të shtetësisë shqiptare, e paraqitur prej përfaqësuesit me prokurë në emër të kërkuuesit duhet të nënshkruhet nga vetë kërkuuesi për sa i përket të dhënave, deklarimeve të lidhura ngushtësisht me kërkuuesin, në emër të të cilit paraqitet kërkesa.

5. Kërkesa për fitimin e shtetësisë shqiptare duhet të përmbajë:

a) emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin ose vendqëndrimin e kërkuuesit;

b) tregimin e fakteve dhe të rrethanave që mbështesin kontributin, në bazë të programeve të veçanta për fitimin e shtetësisë.

6. Në rast se rezulton që kërkesa për fitimin e shtetësisë nuk përmban elementet e mësipërme, kjo përbën shkak për mospranimin e saj.

KREU IV

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR PARAQITJEN E KËRKESËS PËR FITIMIN E SHTETËSISË, SIPAS PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË SHTETËSISË ME INTERES NË FUSHËN E ARSIMIT, SHKENCËS, ARTIT, KULTURËS DHE SPORTIT

1. Për të provuar plotësimin e kriterëve, duhet të paraqiten këto dokumente:

a) kërkesë individuale për fitimin e shtetësisë shqiptare drejtuar AHPVSH-së, nënshkruar personalisht nga kërkuuesi, sipas formatit të përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) kopje e njëzuar me origjinalin e dokumentit të identifikimit;

c) Certifikatë personale e kërkuuesit ose dokumenti i barasvlershëm, i lëshuar sipas legjislacionit të shtetit përkatës;

ç) 3 (tri) fotografi, format dokumenti pasaporte, me përmasa 5 cm x 4 cm, të cilat duhet të jenë bërë jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e kërkesës, të marrë në plan me sfond të bardhë, të fokusuar dukshëm dhe qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me shprehje neutrale dhe sytë të hapur e të dukshëm;

d) vetëdeklarim se nuk ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë në shtetin e origjinës, në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet të tretë për vepra penale, për të cilat ligji shqiptar parashikon dënime jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie, sipas formatit të kërkesës për fitimin e shtetësisë, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

dh) vetëdeklarim se disponon mjete financiare të mjaftueshme për jetesë në Republikën e Shqipërisë, sipas formatit të kërkesës për fitimin e shtetësisë, dhënë në aneksin 1, bashkëlidhur vendimit;

e) vetëdeklarim se do të banojë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të paktën 3 (tre) muaj gjatë 5 (pesë) vjetëve nga miratimi i kërkesës, sipas formatit të kërkesës për fitimin e shtetësisë, dhënë në aneksin 1, bashkëlidhur vendimit;

ë) dëshmi për arritje të shquara në fushën përkatëse që kërkuuesi sjell për shtetin shqiptar, lëshuar nga autoritetet kompetente, si kopje të çmimit/eve ose vlerësimit/eve ose titullit/ujve, nëse është e zbatueshme;



f) rekomandime për merita dhe arritje të veçanta në fushën ku kërkuesi ka kontribut, sipas programeve të veçanta të shtetësisë, lëshuar nga autoritete kompetente ose nga personalitete të fushës apo çdo vlerësim ose rekomandim tjetër, që shërben në mbështetje të kërkesës;

g) deklaratë se informacionet e dhëna prej tij janë të vërteta dhe të sakta, sipas formatit të kërkesës për fitimin e shtetësisë, dhënë në aneksin 1, bashkëlidhur vendimit, si dhe deklarin se kërkuesi është i vetëdijshëm që deklarimi i të dhënave të rreme e ngarkon deklaruuesin me përgjegjësi penale, sipas Kodit Penal, dhe nëse ndodh kjo, përbën shkak ligjor për heqjen e shtetësisë së dhënë.

2. Dokumentet origjinale ose, sipas rastit, kopjet e njësuara të tyre, lëshuar nga organet shtetërore të vendit të origjinës së kërkuesit, duhet të jenë të vërtetuara dhe të legalizuara, në bazë të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare.

3. Dokumentacioni që i bashkëlidhet kërkesës për fitimin e shtetësisë, sipas programeve të veçanta të shtetësisë, duhet të jetë lëshuar brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, afat vlefshmërie ky i përllogaritur nga dita e regjistrimit të kërkesës pranë AHPVSH-së, me përjashtim të dokumenteve që janë të pandryshueshme në përmbajtjen e tyre.

4. Kërkesat për shtetësi pranohen e përpunohen me kusht që të jenë paraqitur sipas formës së kërkuar, të përmbajnë gjenealogjet dhe nënshkrimin e kërkuesit, si dhe të shoqërohen me dokumentet e nevojshme e mandatpagesën, sipas tarifave të miratuara.

KREU V

PROCESI I VERIFIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË KËRKESAVE PËR FITIMIN E SHTETËSISË, SIPAS PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË SHTETËSISË ME INTERES NË FUSHËN E ARSIMIT, SHKENCËS, ARTIT, KULTURËS DHE SPORTIT

1. Pas depozitimit të kërkesës dhe dokumentacionit, AHPVSH-ja, brenda 7 (shtatë) ditëve bën verifikimin paraprak për plotësimin e kushteve formale, të parashikuara në kreun III, të këtij vendimi, si dhe verifikon nëse kërkuesi plotëson kërkesat teknike, vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e dokumentacionit të paraqitur.

2. Në rast se kërkesa nuk plotëson kushtet formale ose kërkesat teknike apo ka mangësi në vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e dokumentacionit, AHPVSH-ja ia kthen atë kërkuesit për plotësimin e të metave, brenda një afati prej jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditësh.

3. Pasi AHPVSH-ja verifikon paraprakisht se kërkesa i përmbush kushtet formale, plotëson kërkesat teknike, vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e dokumentacionit, kryen veprimet, si më poshtë vijon:

a) kryen verifikimet përkatëse për sigurinë kombëtare dhe rendin publik në mënyrë zyrtare nëpërmjet Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

b) i kërkon në mënyrë shkresore ministrisë përgjegjëse për arsimin, shkencën, sportin ose për artin dhe kulturën, në varësi të kontributit të kërkuesit, të vlerësojë kontributin e tij, duke i bashkëlidhur kopje të dëshmimeve dhe akteve të tjera vlerësuese të arritjeve të depozituara nga kërkuesi;

c) ministria përgjegjëse brenda 7 (shtatë) ditëve nga kërkesa për vlerësim kontributi, i përcjell AHPVSH-së në mënyrë zyrtare shkresën e arsyetuar, me të cilin vlerëson se kontributi i kërkuesit përbën interes për shtetin shqiptar, sipas formatit të përcaktuar në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi).

4. Në rast se ministria përgjegjëse vlerëson se kontributi i shtetasit të huaj përbën interes për Republikën e Shqipërisë, AHPVSH-ja vazhdon me procesin e shqyrtimit të kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare, sipas programeve të veçanta të shtetësisë.

5. AHPVSH-ja, pasi shqyrton kërkesën lidhur me përputhshmërinë e kriterëve teknike për fitimin e shtetësisë, vlefshmërinë dhe formën e rregullt ligjore të dokumentacionit, merr konfirmimet zyrtare të verifikimeve të sigurisë dhe të pastërtisë së figurës nga autoritetet kompetente, si dhe vlerësimin pozitiv të kontributit të kërkuesit nga ana e ministrisë përgjegjëse, përgatit një relacion drejtuar ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike për plotësimin e kriterëve ligjore nga ana e kërkuesit.

6. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, pas vlerësimit të relacionit për plotësimin e kriterëve ligjore, i përcjell Presidentit të Republikës propozimin për fitimin e shtetësisë shqiptare, sipas programeve të veçanta.



7. Në rast se përgjigjet zyrtare të verifikimeve të sigurisë dhe të pastërtisë së figurës nga autoritetet kompetente vlerësojnë se kërkuksi përbën kërcënim për rendin publik dhe sigurinë kombëtare ose në rast se ministria përgjegjëse vlerëson se kontributi i kërkuksit nuk përbën interes në fushat e përcaktuara në këtë vendim për Republikën e Shqipërisë, AHPVSH-ja përgatit një relacion informues drejtuar ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike për mosplotësimin e kriterëve teknike nga kërkuksi.

8. Ministri përgjegjës për rendin e sigurinë publike, pas vlerësimit të relacionit dhe konstatimit të mosplotësimit të kriterëve teknike, refuzon kërkesën për fitimin e shtetësisë.

9. AHPVSH-ja njofton kërkuksin në adresën e deklaruar në formularin e kërkesës për refuzimin e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare.

KREU VI

RREGULLAT E KRYERJES SË VERIFIKIMEVE DHE KONTROLLEVE TË NEVOJSHME PËR FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE KUR REPUBLIKA E SHQIPËRISË KA INTERES KOMBËTAR

1. Në rastet kur Republika e Shqipërisë ka interes kombëtar, institucioni i Presidentit ose Kryeministria apo ente të autorizuar prej tyre paraqesin kërkesën për fitim shtetësie, sipas programeve të veçanta të shtetësisë pranë Ministrisë së Brendshme (AHPVSH), e cila duhet të përmbajë gjenealitetet e individit.

2. AHPVSH-ja kryen procedurën e përsheptuar të verifikimeve përkatëse për sigurinë kombëtare dhe rendin publik në mënyrë zyrtare nëpërmjet Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

3. AHPVSH-ja, pasi merr konfirmimet zyrtare të verifikimeve të sigurisë dhe të pastërtisë së figurës nga autoritetet kompetente, përgatit një relacion

drejtuar ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike për plotësimin e kriterëve ligjore nga ana e kërkuksit.

4. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, pas vlerësimit të relacionit për plotësimin e kriterëve ligjore, i përcjell Presidentit të Republikës propozimin për fitimin e shtetësisë shqiptare, sipas programeve të veçanta.

5. Procedura e shqyrtimit të kërkesës për fitimin e shtetësisë, sipas programeve të veçanta kur Republika e Shqipërisë ka interes kombëtar, përfundon brenda 7 (shtatë) ditëve.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 6.4.2022, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave të aplikimit, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare për kontribut të veçantë në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit”, të ndryshuar, dhe nr. 151, datë 11.3.2022, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave të aplikimit, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare për kontribut të veçantë në fushën e artit e të kulturës”, shfuqizohen.

2. Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ministri përgjegjës për arsimin dhe sportin, ministri përgjegjës për kulturën dhe Agjencia për Hartimin e Programeve të Veçanta të Shtetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



ANEKS 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHMEAGJENCIA E HARTIMIT TË PROGRAMEVE
TË VEÇANTA TË SHTETËSISËKËRKESË PËR FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE, SIPAS PROGRAMEVE TË
VEÇANTA TË SHTETËSISË
*ALBANIAN CITIZENSHIP APPLICATION THROUGH SPECIAL CITIZENSHIP
PROGRAMS*

Informacion i përgjithshëm Informacioni dhe dokumentacioni jo i plotë ose i rremë do të vonojë procesimin e kërkesës dhe mund të çojë në refuzimin e saj. Plotësoni me kujdes dhe nënshkruani kërkesën. Formulari i kërkesës së bashku me dokumentacionin shoqëruar do të dorëzohet në Agjencinë e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë nga vetë kërkuuesi ose përfaqësuesi i tij ligjor, dorazi ose nëpërmjet shërbimit postar. Mbrojtja e të dhënave personale Kontrolli, verifikimi dhe përpunimi i të dhënave personale të kërkuarit do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi të shtetit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale. Kontrolli i të dhënave përfshin verifikimin e identitetit të kërkuarit dhe bashkëpunimin me organet kompetente lidhur me verifikimin e të dhënave ndaj kërkuarit. Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat e njeriut dhe në veçanti të drejtën e respektimit të jetës private. Ky formular do të pranohet nëse: 1. Është plotësuar nga vetë kërkuuesi, në dorëshkrim, me shkronja kapitale dhe pa korrigjime. 2. Nuk ka rubrika të paplotësuara. 3. Kërkuuesi vendos emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin në fund të çdo faqeje	General information: <i>Incomplete or false information and documentation will delay the processing of the application and may lead to its rejection. Fill out the application carefully and sign it.</i> <i>The application form together with the accompanying documentation will be submitted to the Agency for Drafting Special Citizenship Programs by the applicant himself or his legal representative, by hand or through the postal service.</i> Protection of personal data: <i>The control, verification and processing of the applicant's personal data will be done in accordance with the legislation in force of the Albanian state for the protection of personal data.</i> <i>The control of the data includes the verification of the identity of the applicant and the cooperation with the competent bodies related to the verification of the data on the applicant.</i> <i>The legal processing of personal data is done respecting and guaranteeing human rights and in particular the right to respect for private life</i> This form will be accepted if: 1. It was completed by the applicant himself, in handwriting, with capital letters and without corrections. 2. There are no unfilled columns. 3. The applicant puts his name, surname and signature at the bottom of each page				
Seksioni I / Section 1					
Unë po paraqes kërkesën për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programeve të veçanta të shtetësisë për kontribut të veçantë në fushën e: <i>I am applying for Albanian citizenship through special citizenship programs for special contribution in the field of:</i> <table><tr><td>a) arsim / education ☐</td><td>b) shkencë / science ☐</td></tr><tr><td>c) sport / sport ☐</td><td>d) art dhe kulturë / art and culture ☐</td></tr></table>		a) arsim / education ☐	b) shkencë / science ☐	c) sport / sport ☐	d) art dhe kulturë / art and culture ☐
a) arsim / education ☐	b) shkencë / science ☐				
c) sport / sport ☐	d) art dhe kulturë / art and culture ☐				



Seksioni II / Section 2

Emri/ <i>Name:</i>	
Mbiemri/ <i>Surname:</i>	
Atësia/ <i>father's name:</i>	
Amësia/ <i>mothers name:</i>	
Datëlindja/ <i>date of birth:</i>	___/___/___
Gjinia/ <i>Sex:</i>	M ☐ / F ☐
Gjendja civile/ <i>marital status:</i>	
Gjuha amtare/ <i>native language:</i>	
Dokument identifikimi / <i>ID</i>	Nr./No. _____ Datë/ <i>Date:</i> ___/___/___
Shtetësia e vendit të origjinës/ <i>Nationality of country of origin:</i>	
Vendlindja/ <i>Birthplace:</i>	
Vendbanimi/ <i>Residency:</i>	
Email/ <i>e-mail:</i>	
Telefon/ <i>phone:</i>	
Shtetësi të tjera të fituara/ <i>Other citizenships acquired:</i>	
Shteti ku keni pasur qëndrim të ligjshëm 6 (gjashtë) muajt e fundit nga data e aplikimit/ <i>The country where you have had legal residence for the last 6 (six) months from the date of application:</i>	
Shtete të tjera ku keni pasur qëndrim të ligjshëm jo më pak se 6 (gjashtë) muaj brenda 3 (tre) viteve të fundit nga data e aplikimit/ <i>Other countries where you have had legal residence for no less than 6 (six) months within the last 3 (three) years from the date of application:</i>	

Seksioni III/ Section 3

Arsyet e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare/ *Reasons for applying for Albanian citizenship*

Përkrahja arsyet e aplikimit, faktet dhe rrethanat që mbështesin kërkimin për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programeve të veçanta të shtetësisë/ *Describe the reasons for the application, the facts and circumstances that support the search for the acquisition of Albanian citizenship through special citizenship programs:*

Seksioni IV / Section 4

Deklarime/ *Statements***1.Deklarimi i prezencës në territorin e Republikës së Shqipërisë/ *Statement of presence in the territory of the Republic of Albania:***

Unë/ *I* _____ deklaroj se në zbatim të legjislacionit në fuqi të shtetit shqiptar, për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programeve të veçanta të shtetësisë për kontribut të veçantë, pas fitimit të shtetësisë shqiptare do të banoj në



territorin e Republikës së Shqipërisë, për një periudhë më të gjatë se 3 (tre) muaj gjatë 5 (pesë) viteve, në një banesë (pasuri të paluajtshme në shtetin shqiptar), të cilën do e disponoj/

declare that in compliance with the legislation in force of Albania, for obtaining Albanian citizenship through Special Programs for a special contribution, I will reside in the territory of the Republic of Albania, for a period longer than 3 (three) months during 5 (five) years, in an apartment (real estate in the Albanian state) as stated below:

- a) me kontratë qiraje/ *rent* ☐
b) me titull pronësie/ *own a property* ☐
c) tjetër/ *other*: _____ ☐

Unë/ I _____ deklaroj se kam të ardhura të mjaftueshme për të përballuar jetesën në Shqipëri/ *declare that I have sufficient income to afford the living cost in Albania.*

2. Deklarim i gjendjes gjyqësore/ *Statement of Judicial Status*

Unë/ I _____ deklaroj që/ *Declare that:*

Kam qenë/ *have been* ☐ / nuk kam qenë/ *have not been* ☐

i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë në shtetin e origjinës, në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet të tretë për vepra penale, për të cilat ligji shqiptar parashikon dënime me jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie përveçse kur dënimi është dhënë për motive politike/ *Convicted by a final court decision in the country of origin, in the Republic of Albania or in any third country for criminal offenses for which Albanian law provides punishments of not less than 3 (three) years of imprisonment, except when the punishment it was given for political reasons.*

Në rast dënimi ju lutem specifikoni/ *In case of conviction please indicate:*

Shtetin ku jeni dënuar/ *The state where you were convicted:* _____

Veprën penale/ *The criminal offense:* _____

Lloji i dënimit/ *type of conviction:* _____

Vendim/et gjyqësor i formës së prerë / *Final judicial decision/s* (Numër dhe data e vendimit/ *Number and date of the judicial decision*): _____
(bashkëlidhni një kopje të vendimit/ *attach a copy of judicial decision*)

3. Deklarim për rekordet kriminale në listat e organizatave ndërkombëtare, partnere të sigurisë/ *Statement on being registered as a person with a criminal record in the lists of international organizations, security partners*

Unë deklaroj që / *I declare that:*

☐ Kam qenë/ *I have been* ☐ Nuk kam qenë/ *I have not been*

i regjistruar si person me rekorde kriminale në listat e organizatave ndërkombëtare, partnere të sigurisë/ *registered as a person with a criminal record in the lists of international organizations, security partners;*

4. Deklarime përfundimtare/ *Final declarations:*

Unë (emër, mbiemër) / *I (name, name)* _____

po paraqes kërkesën për fitimin e shtetësisë shqiptare sipas programeve të veçanta të shtetësisë dhe me anë të kësaj deklarate konfirmoj me nënshkrimin tim se:

i. pranoj me vullnetin tim të lirë dhe jap pëlqimin për

I am applying for Albanian citizenship according to the special citizenship programs and by means of this statement I confirm with my signature that:

i. I accept of my own free will and give my consent to the collection,



mbledhjen, kontrollin, verifikimin, përpunimin e të dhënave të mia personale në kuadër të kërkesës time për fitimin e shtetësisë shqiptare.

ii. jam i vetëdijshëm që Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë rezervon të drejtën për të verifikuar çdo informacion personal lidhur me mua dhe mund të kryejë verifikime në bashkëpunim me organet ligjzbatuese për të marrë të dhëna për mua si kërkuar.

iii. informacioni i paraqitur në këtë kërkesë dhe dokumentacioni bashkëlidhur janë të vërteta dhe të sakta.

iv. jam i vetëdijshëm se dorëzimi i dokumentacionit të rremë dhe dhënia e informacionit personal të rremë me shkrim, është një veprë e dënueshme sipas Kodit Penal në Shqipëri dhe se informacioni i rremë mund të çojë në refuzimin e kërkesës time për fitimin e shtetësisë shqiptare në zbatim të legjislacionit në fuqi për shtetësinë shqiptare.

control, verification, processing of my personal data in the context of my request to obtain Albanian citizenship.

ii. I am aware that the Special Citizenship Programs Designation Agency reserves the right to verify any personal information about me and may conduct verifications in cooperation with law enforcement agencies to obtain data on me as an applicant.

iii. the information presented in this application and the accompanying documentation are true and correct.

iv. I am aware that submitting false documentation and providing false personal information in writing is a punishable offense under the Criminal Code in Albania and that false information may lead to the rejection of my application for Albanian citizenship pursuant to legislation in force for Albanian citizenship.

Seksioni V / Section V

Dorëzimi i formularit të aplikimit dhe dokumentacionit / Submission of application form and documentation

Ky formular dhe dokumentacioni bashkëlidhur do dorëzohet pranë Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë / This application form and related documentation will be submitted to the Agency for Drafting Special Citizenship Programs:

- a) nga vetë aplikuesi / by the applicant himself ☐
b) nga përfaqësuesi me prokurë / by the representative with power of attorney ☐

Në rast të pikës b) specifikoni / In case of point b) specify:

Emër i përfaqësuesit / Name of representative: _____

Mbiemër i përfaqësuesit / Surname of representative: _____

Dokument identifikimi i përfaqësuesit / Identification document of the representative:

Nr./No____, datë/ date ____/____/____

Nr. Akti i përfaqësimit / No. Act of representation: ____

Datë Akti i përfaqësimit / Date of Act of representation: ____/____/____

Së bashku me këtë formular depozitohen dokumentet përmbledhëse sipas listës bashkëlidhur. / Along with this form, the summary documents are filed according to the attached list.

ANEKS 2

Vlerësimi nga ministria përgjegjëse për arsimin, shkencën dhe sportin ose ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën do të përmbajë formatin e tekstit, si më poshtë vijon:

“Lënda: Mendim/vlerësim mbi kontributin për fitimin e shtetësisë Shqiptare, sipas programeve të veçanta të shtetësisë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. ____ datë____, me lëndë “Mbi vlerësimin e kontributit në fushën e ____ për z./Znj. _____, i cili ka kërkuar të fitojë shtetësinë shqiptare nëpërmjet programeve të veçanta të shtetësisë”, regjistruar në Ministrinë e _____ me nr._____, datë_____, ju bëjmë me dije, si më poshtë vijon:

Në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, dhe të shkronjës “c”, të pikës 3, të kreut V, të vendimit nr. ... të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave të kërkesës, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare kur Republika e Shqipërisë ka interes kombëtar apo interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës dhe sportit”, Ministria _____, pasi shqyrtoi dokumentacionin bashkëlidhur dhe duke vlerësuar ____ (P.sh.: CV, dëshminë, rekomandimin nga federata etj.) vlerëson së z./znj._____ përbën interes në fushën e _____, pasi kontributi i tij/saj në fushën e _____ vlerësohet me interes për Republikën e Shqipërisë.”



VENDIM

Nr. 141, datë 13.3.2024

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Ana Kapaj emërohet zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 143, datë 13.3.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 332, DATË 31.5.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT ‘NDËRTIMI I
AKSIT RRUGOR THUMANË–VORË–
KASHAR’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 332, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë, objekt shpronësimi, me një vlerë të përgjithshme prej 1 341 870 037.48 (një miliard e treqind e dyzet e një milionë e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e tridhjetë e shtatë pikë dyzet e tetë) lekësh.”.

b) Në pikën 4, vlera “420 537 115.55 (katërqind e njëzet milionë e pesëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e pesë) lekë” zëvendësohet me vlerën “1 341 870 037.48 (një miliard e treqind e dyzet e një milionë e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e tridhjetë e shtatë pikë dyzet e tetë) lekë”.

2. Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria “G2 Infra” sh.p.k., Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Krujë, Kamzë–Vorë, Tiranë Rurale 2, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës dhe Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA EMËRORE SHITESË E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI I AKSIT RRUGOR “THUMANË–VORË–KASHAR”

PRONARI														VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM												SHËNIMET "KUËZIMET HIPOTEKORE, BARRË MBI PASURI ETJ")"					
TË DHËNAT KADASTRALE SIPAS KARTELËS SË PASURISË					ARË			TRUALL			NDËRTËSË BANIMI			NDËRTËSË SOCIAL EKONOMIKE			VLERA E KULTURAVE BUDOESORE DHE DRUFRTORËREVE SIPAS PROCESVEBALIT TË DREJTORES SË BUQËSISË		VLERA E KULTURAVE BUDOESORE (shk.)	VLERA E DRUFRTORËREVE (shk.)	Vlera totale (shk.)	ZH									
No. rresht	No. i parcelimit	Emri	Adresa	Mbikam	Fshati me qytet	Z. kod. arabe	No. i parcelit	Lendi i parcelit	Spërfaqja totale	*Aq ² (m ²)	*Trrall ² (m ²)	*Ndërtim ² (m ²)	Volumi	Faqe	Spërfaqja (m ²)	Çmimi (shk./m ²)	Vlera (shk.)	Spërfaqja (m ²)	Çmimi (shk./m ²)	Trrall	Spërfaqja (m ²)	Çmimi (shk./m ²)	Vlera (shk.)	Spërfaqja ndërtim me përkatësi (m ²)	Çmimi (shk./m ²)	Vlera (shk.)	Y= (P)+(Q)+(V)+(N)+(Z)				
		A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L		N	O	P = (N) x (O)	Q	R	S = (Q) x (R)	T	U	V = (T) x (U)				X	Z			
484	194	Leo	Lalash	Doda	Bibaj	1185	87/18	Ast + muall	5,000	4,700	300	91					-	187	235	43,945.00							-	4,684,945.00	Konf. ASHK. Lape legjitimit me 133727, datë 30.1.2015, Godshë banimi 1-katshë.		
485	751	Shkëqim	Hasan	Cani	Armenas	1042	330/47	Ast	1,772	1,772			13	29	1,317.00	318.00	418,006.00			-									418,006.00	Konf. ASHK. Kartela përmetuesh/penduesh me ref. 00003534 dhe ref. dokument = 297 m ² , si depozitimi plani i rrethimit për përcaktimin e sipërfaqes 1478 m ² që ndodhet me dokument.	
486	752	Shkëqim	Hasan	Cani	Armenas	1042	330/48	Trrall	300		300	99	13	30			-	171.00	442.00	75,382.00			207.00	51,000.00	10,557,000.00				10,632,582.00	Konf. ASHK. Kartela përmetuesh/penduesh me ref. 00003535. Lape legjitimit me 157243, dt. 10.1.2015 godshë banimi 2-katshë, sip. kat. përdhe 99 m ² sip. kat. përdhe 108 m ² .	
487	756	Bubllim	Dok	Cani	Armenas	1042	330/49	Ast	1,400	1,400			13	147	245.00	318.00	77,910.00			-									77,910.00	Konf. ASHK. Kartela përmetuesh/penduesh me ref. 00003541 dhe ref. dokument = 390 m ² si depozitimi plani i rrethimit për përcaktimin e sipërfaqes 890 m ² që ndodhet me dokument.	
488	757	Bubllim	Dok	Cani	Armenas	1042	330/40	Ast	1,685	1,685			10	37	22.00	318.00	6,996.00	-												6,996.00	Konf. ASHK. Kartela përmetuesh/penduesh me ref. 00003542 dhe ref. dokument = 138 m ² si depozitimi plani i rrethimit për përcaktimin e sipërfaqes 1327 m ² që ndodhet me dokument saktësisht kufiri ref. 00000619.
		Flutura	Dok	Cani																											
		Mimosa	Dok	Cani																											
		Miranda	Muharem	Cani																											
		Muharem	Dok	Cani																											
		Nashe	Hysen	Cani																											
		Petit	Dok	Cani																											
		Flamur	Dok	Cani																											
489	759	Genç	Hasan	Cani	Armenas	1042	330/11/1	Trrall			100	90	9	90			-	42.00	442.00	18,564.00				90.00		1,421,839.50		1,440,403.50	Konf. ASHK. Kartela përmetuesh/penduesh me REF. 0000353716.		
490	760	Genç	Hasan	Cani	Armenas	1042	330/11	Ast	1,039				1	240	624	318.00	198,432.00			-								198,432.00	Konf. ASHK. Kartela përmetuesh/penduesh me REF. 00003536 dhe ref. dokument = 130 m ² si depozitimi plani i rrethimit për përcaktimin e sipërfaqes 13.		
491	762	Genç	Hasan	Cani	Armenas	1042	330/13	Trrall			200	160	7	15			-	2.00	442.00	884.00			104.00	51,000.00	5,304,000.00			5,304,084.00	Konf. ASHK. Kartela përmetuesh/penduesh me REF. 00003532 dhe ref. dokument = 17. Objektiv i kësaj hënës banimi dhe i kësaj përdhë me kat. muall sip. pronat. Sa i përket diferencës orizontale dokument vjen si rrethim të pronat e ka shprehur me rrethim të objektit. Shprehimi i objektit dhe si kësaj sip. muall sip. pronat.		
492	763	Edlira	Mylim	Shëta	Armenas	1042	330/14	Trrall	200		200	102	7	16			-	82.00	442.00	36,244.00	193.00	51,000.00	9,945,000.00						9,979,244.00	Konf. ASHK. Kartela përmetuesh/penduesh me ref. 00003532 dhe ref. dokument = 130 m ² si depozitimi plani i rrethimit për përcaktimin e sipërfaqes 13. Objektiv i kësaj hënës banimi dhe i kësaj përdhë me kat. muall sip. pronat. Sa i përket diferencës orizontale dokument vjen si rrethim të pronat e ka shprehur me rrethim të objektit. Shprehimi i objektit dhe si kësaj sip. muall sip. pronat.	
493	764	Rinaldo	Petit	Cani																											
494	765	Skender	Muharem	Gorra	Armenas	1042	330/16	Trrall			200	60	7	18			-	200.00	442.00	88,400.00			60.00	51,000.00	3,060,000.00			3,148,400.00	Konf. ASHK. Kartela përmetuesh/penduesh me ref. 00003535.		
495	766	Agim	Muharrem	Lala	Armenas	1042	330/17	Trrall			200	60	7	19			-	200.00	442.00	88,400.00	60.00	51,000.00	3,060,000.00						3,148,400.00	Konf. ASHK. Kartela përmetuesh/penduesh me ref. 00003536.	
		Fatjeda	Agim	Lala																											
		Francisko	Agim	Lala																											
		Vasilje	Mirdi	Lala																											
496	767	Flamur	Dok	Cani	Armenas	1042	330/45	Trrall			100	80	11	130			-	100.00	442.00	44,200.00			80.00	51,000.00	1,260,000.00			1,274,200.00	Konf. ASHK. Kartela përmetuesh/penduesh me ref. 00003537. Objektiv banimi i përdhë me kat. muall sip. pronat. Sa i përket diferencës orizontale dokument vjen si rrethim të pronat e ka shprehur me rrethim të objektit. Shprehimi i objektit dhe si kësaj sip. muall sip. pronat.		
497	768	Engjet	Ramazan	Cani	Armenas	1042	330/18	Trrall			200	80	7	21			-	200.00	442.00	88,400.00			80.00	51,000.00	4,080,000.00			4,168,400.00	Konf. ASHK. Kartela përmetuesh/penduesh me ref. 00003561. Objektiv banimi i përdhë me kat. muall sip. pronat. Sa i përket diferencës orizontale dokument vjen si rrethim të pronat e ka shprehur me rrethim të objektit. Shprehimi i objektit dhe si kësaj sip. muall sip. pronat.		
498	Edhurat	Mirafa	Shura	Armenas	1042	330/33	Trrall				200	90	9	91			-		191	442	84,422.00				-			84,422.00	Konf. ASHK. Kartela përmetuesh/penduesh me ref. 00003559. Objektiv muall sip. pronat. Sa i përket diferencës orizontale dokument vjen si rrethim të pronat e ka shprehur me rrethim të objektit. Shprehimi i objektit dhe si kësaj sip. muall sip. pronat.		

Page | 5531

[illegible]

Viti 2024 – Numri 49

														VLERËSIMI PËR SHPRËSIM																		
PRONARI					TË DHËNAT KADASTRALE SIPAS KARTELES SË PASURISË										ARË			TRUALL			NDËRTËSË BANIMI			NDËRTËSË SOCIAL EKONOMIKE			VLERA E KULTURAVE BUQËSORE DHE DRU- FRUTOREVE SIPAS PROCESVERBALIT TË DREJTORISË SË BUQËRISË			SHËNIMET "KUQIZIMET HUPOTEKORË, BARRË MBË PASURI ETJ."		
Nr. rrethit	Nr. / parafjalimit	Rrethi	Adresa	Mbikemimi	Faketi (nr. qyteti)	Z. kadastrale	Nr. / parafjalimit	Lidhje / parafjalimit	Spërfaqja totale	%q (q.m)	"Trrall" (q.m)	"Ndërtesa" (m)	Volumi	Faqe	Spërfaqja (m)	Çmimi (ë.k./m)	Vlera (ë.k.)	Spërfaqja (m)	Çmimi (ë.k./m)	Trrall	Spërfaqja banimi (m)	Çmimi (ë.k./m)	Vlera (ë.k.)	Spërfaqja ndërtimit me prerje (m)	Çmimi (ë.k./m)	Vlera (ë.k.)	Vlera e kalimit bregdetor (ë.k.)	Vlera e dështimit (ë.k.)	Vlera totale (ë.k.)			
525	813	Perrit	Solejman	Muka	Bërull	1167	12/14/1	Asi	2384	2384			12	169	30400	448	136192				0			0					136192	Konf. ASHK. Kartela përmitësit/ përditësit diferencë dokument-fakt=616 me m. gën.		
526	820	Gjiron	Oman	Muka	Bërull	1167	12/19	Asi	2380	2380			17	133	48300	448	217280				0			0						217280	Konf. ASHK. Kartela përmitësit/ përditësit me ref. 00005424, diferencë dokument fakt=700 me shprehje të detyrueshme plus elevum për shpërfaqjen 2300 sqm dokumenti.	
		Drita	Sabri	Muka																												
		Gjiron	Gjiron	Muka																												
		Eti	Miler	Marulla																												
		Omec	Gjiron	Muka																												
Gineola	Gjiron	Shopi																														
527	862	Xhemal	Tahir	Koni	Bërull	1167	13/3	Asi	4500	4500	0	0	11	22	2,663.00	448	1193024	-	0	0	0	0	0	0					1193024	Konf ASHK. Me referencën 00004765 u bë përmitësimi /përditësimi i kësaj kartele		
528	863	Gjiron	Ramazan	Koni	Bërull	1167	13/54	Asi	8500	8500	0	0	16	222	1,883.00	448	843384	-	0	0	0	0	0	0	0					843384	Konf ASHK. Mbi këtë pasuri ndodhet një shprehje pa kështu. Me referencën 00004824 bë përmitësimi /përditësimi i kësaj kartele . Mbi këtë pasuri pozicionet në objektin para 51 paqenjtë në Hartën e Zorës. Objekti nuk përfshihet nga rregulli. Posahtet ndodhin konfirmuar me dhënie të krahut përparë me ref. 477/1 prot datë 05.02.2024 të ASHK. Komitë-Vite.	
529	863	Mahamret	Ramazan	Koni	Bërull	1167	13/30	Asi	8500	8500	0	0	16	80	2,701.00	448	1210048	-	0	0	0	0	0	0	0					1210048	Konf ASHK. Mbi këtë pasuri ndodhet një shprehje ndoshta pa kështu. Me referencën 00004824 bë përmitësimi /përditësimi i kësaj kartele . Mbi këtë pasuri pozicionet në objektin para 51 paqenjtë në Hartën e Zorës. Objekti nuk përfshihet nga rregulli.	
PRONARI				TË DHËNAT KADASTRALE SIPAS KARTELËS SË PASURISË										ARË	TRUAJL			NDËRTËSË E BANIMIT			NDËRTËSË SOCIALE EKONOMIKE			VLERË E KULTURAVE BUDORORE DHE DRUHOREVE SIPAS PROCESVEFRALIT TË DREJTORISË SË BUQËRSISË		SHËNIMET "KUZIZIMET HIPOTEKORE, BARRË MBI PASURI ETJ."					
No. rrethit	No. i pajordhimit	Emri	Adresa	Mbështet	Pikëzimi i qytetit	Z. katrorëshe	No. i pajordhimit	Lloji i pajordhimit	Specifikimi i ndërtimit	"Në qytet"	"Tërfaqe" (m ²)	"Ndërtim" (m ²)	Volumi	Pesha	Spërfaqja (m ²)	Çmimi (ë.k./m ²)	Vlera (ë.k.)	Spërfaqja (m ²)	Çmimi (ë.k./m ²)	Tërfaqe	Spërfaqja katimit (m ²)	Çmimi (ë.k./m ²)	Vlera (ë.k.)	Spërfaqja ndërtimit me përcentazh (m ²)	Çmimi (ë.k./m ²)	Vlera (ë.k.)	Vlera e kaluarit hapësiror (ë.k.)	Vlera e drejtimit (ë.k.)	Vlera e kaluarit (ë.k.)		
683	1079	Shoqëria "Alta Group" sh.p.k.	Shoqëria "Alta Group" sh.p.k.	Shoqëria "Alta Group" sh.p.k.	Kashar	2105	971/66	Truall	7433.43		7433.43	3522.2	25	163			0	107.00	4242	453894				0					453894	Engjërimet "shpirtësi KNP" - L.2011/926, vepërime të cilat kanë qenë të përbashkëta të objektit që ndodhet me pasuritë nr. - 971/46/2 mak ndalim me qendrueshmëri të cilat që ndodhet me pasuritë nr. - 971/46/1.	Konf. ASHK. Nr. reg. 0006140 dt. 10.08.2022 Bunka OEP Albania K. Lig. Nr. 2078 qy Nr. 401 datë 03.08.2022. Vepërime të cilat që ndodhet me shërbimet ekonomike "Talia Ventes Denge" në anën veriore, struktura industriale meqenëse dhe zyrë ekonomike 1.5 kat dhe katërt dhe 1 kat. Kjo pasuri e përmbledhur / përditësuar me ref 00006720.
684	1080	Xhorxhor	Halik	Daku	Kashar	2105	971/30	Atë	2198	2198			17	48	1,837.00	448	831936							0					831936	Konf. ASHK. Kjo pasuri e përmbledhur / përditësuar me ref 00006094, mungon ref 00006098.	
684		Hajdar	Halik	Daku																											
684		Bjor	Halik	Daku																											
684		Gani	Halik	Daku																											
685	1082	Shoqëria "Daku" sh.p.k.	Shoqëria "Daku" sh.p.k.	Shoqëria "Daku" sh.p.k.	Kashar	2105	971/60	Truall	3617		3617	290	21	12			0	1,040.00	4242	4411680				208			3826384705		8258064705	Konf. ASHK. Nr. reg. 00002560 dt. 13.03.2014. U kërkoj informata të pasurisë sipas aktit të ekzekutimit të depozituar në vlerën 13330800 leke bashkëdhjetë kësaj referencë me kodin nr. - 13.03.2014. nr. - reg. 0000677 dt. 02.09.2023. Më ka pasur përbashkëti dhe një ndërtim me sip. 132 m ² . Leje legjitimim nr. 66392 dt. 16.05.2010 dhe 1 kat i objektit Bunka OEP Albania K. Lig. Nr. 2078 qy Nr. 401 datë 03.08.2022. Vepërime të cilat që ndodhet me shërbimet ekonomike "Talia Ventes Denge" në anën veriore, struktura industriale meqenëse dhe zyrë ekonomike 1.5 kat dhe katërt dhe 1 kat. Kjo pasuri e përmbledhur / përditësuar me ref 00006720.	
686	1083	Shoqëria "Daku" sh.p.k.	Shoqëria "Daku" sh.p.k.	Shoqëria "Daku" sh.p.k.	Kashar	2105	971/62	Atë	120		120		21	14	120.00	448	53760							0					53760	Konf. ASHK. Kjo pasuri e përmbledhur / përditësuar me ref 00006739 mungon ref 00006731 me kodin nr. - 13.03.2014 dt. 12.2.2014 dt. D. Kambur i be rezervuar për 30 ditë me kodin nr. - 25765 datë 17.03.2014, në L.V. anëtarë të be rezervuar për 30 ditë.	
687	1084	Shoqëria "Daku" sh.p.k.	Shoqëria "Daku" sh.p.k.	Shoqëria "Daku" sh.p.k.	Kashar	2105	971/61	Atë	43		43		21	13	43.00	448	19264							0					19264	Konf. ASHK. Kjo pasuri e përmbledhur / përditësuar me ref 00006721 mungon ref 00006653.	
688	1086	Bukllim	Ideta	Almetra	Kashar	2105	971/1	Atë	1750		1750		7	223	321.00	448	143808							0					143808	Konf. ASHK. Kjo pasuri e përmbledhur / përditësuar me ref 00006739 mungon ref 00006629.	
689	1088	Lalim	Shohaj	Shohaj	Kashar	2105	78/16	Atë	12800	12800			1	39	9,972.00	448	4467456							0					4467456	Konf. ASHK. Nr. reg. 00005380 dt. 23.01.2021. Në këtë pasuri ndodhet ndërtim e regjistruar me vol. 27 fq. 204. Nr. - reg. 00006901 dt. 20.09.2023. Vepërime të cilat që ndodhet me shërbimet ekonomike "Talia Ventes Denge" në anën veriore, struktura industriale meqenëse dhe zyrë ekonomike 1.5 kat dhe katërt dhe 1 kat. Kjo pasuri e përmbledhur / përditësuar me ref 00006720.	
689	Atë	Shohaj	Shohaj																												
690	1089	Kajm	Qemil	Gjika																											
690	1089	Andan	Qemil	Gjika																											
691	1090	Andan	Qemil	Gjika	Kashar	2105	78/60	Truall	2153		2153	1201.5	23	222			0	2,153.00	4242	9133026				2051.4			47283,329.83		56416553.83	Objekti 2 katërkates me lëvizshmëri "Leje Legjitimim Nr. 131581 dt. 02.08.2018. 2 katërkates ndërtim. Në këtë ndodhet ndërtim e regjistruar me volim 27 fq. 204. Nr. - reg. 00006901 dt. 20.09.2023. Më ka pasur përbashkëti dhe një ndërtim me sip. 132 m ² . Leje legjitimim nr. 66392 dt. 16.05.2010 dhe 1 kat i objektit Bunka OEP Albania K. Lig. Nr. 2078 qy Nr. 401 datë 03.08.2022. Vepërime të cilat që ndodhet me shërbimet ekonomike "Talia Ventes Denge" në anën veriore, struktura industriale meqenëse dhe zyrë ekonomike 1.5 kat dhe katërt dhe 1 kat. Kjo pasuri e përmbledhur / përditësuar me ref 00006720.	
692	1091	Amroda	Abas	Hothallari	Kashar	2105	978/21	Atë	6620		6620		27	202	5,687.00	448	2547776							0					2547776	Konf. ASHK. Nr. reg. 00005380 dt. 23.01.2021. Në këtë pasuri ndodhet ndërtim e regjistruar me volum 27 fq. 204. Nr. - reg. 00006901 dt. 20.09.2023. Vepërime të cilat që ndodhet me shërbimet ekonomike "Talia Ventes Denge" në anën veriore, struktura industriale meqenëse dhe zyrë ekonomike 1.5 kat dhe katërt dhe 1 kat. Kjo pasuri e përmbledhur / përditësuar me ref 00006720.	
693	1118	Amroda	Abas	Hothallari	Kashar	2105	972/1/20	Atë/Truall	10300		9256	1044	440	27	203	5,270.00	448	2560960	985.00	4242	4178370			440				5022353.05		11561633.61	Konf. ASHK. Nr. reg. 00005380 dt. 23.01.2021. Në këtë pasuri ndodhet ndërtim e regjistruar me vol. 27 fq. 204. Nr. - reg. 00006901 dt. 20.09.2023. Vepërime të cilat që ndodhet me shërbimet ekonomike "Talia Ventes Denge" në anën veriore, struktura industriale meqenëse dhe zyrë ekonomike 1.5 kat dhe katërt dhe 1 kat. Kjo pasuri e përmbledhur / përditësuar me ref 00006720.
694	1093	Rexhep	Bimlim	Shehi	Kashar	2105	78/24	Atë	185		185		1	49	185.00	448	81984							0					81984	Konf. ASHK.	
695	1094	Bukllim	Fozulla	Mali	Kashar	2105	78/63	Truall	1649.2		1649.2	398.2	30	113			0	1,649.20	4242	6993906.4				1328.7			30683012.04		37679018.44	Konf. ASHK. Differencë fakt-ditë=51.30 m ² ndërtim. U' depozituar shpërtim e ndërtim me ref 00006720 me kodin nr. - 13.03.2014 dt. 12.2.2014 dt. D. Kambur i be rezervuar për 30 ditë me kodin nr. - 25765 datë 17.03.2014, në L.V. anëtarë të be rezervuar për 30 ditë.	
696	1095	Gon 2004	Gon 2004	Gon 2004	Kashar	2105	78/57	Truall	153		153	92	25	188			0	153.00	4242	649026				14			5367659.084		601685.084	Konf. ASHK. Differencë fakt-ditë=13.9 m ² ndërtim. Depozituar ndërtim e ndërtim me ref 00006720 me kodin nr. - 13.03.2014 dt. 12.2.2014 dt. D. Kambur i be rezervuar për 30 ditë me kodin nr. - 25765 datë 17.03.2014, në L.V. anëtarë të be rezervuar për 30 ditë.	
697	1096	Bukllim	Fozulla	Mali	Kashar	2105	78/64	Truall	703		703		30	114			0	70.30	4242	298212.6				0					298212.6	Konf. ASHK. Differencë fakt-ditë=51.3 m ² ndërtim. U' depozituar shpërtim e ndërtim me ref 00006720 me kodin nr. - 13.03.2014 dt. 12.2.2014 dt. D. Kambur i be rezervuar për 30 ditë me kodin nr. - 25765 datë 17.03.2014, në L.V. anëtarë të be rezervuar për 30 ditë.	
698	1097	Gon 2004	Gon 2004	Gon 2004	Kashar	2105	78/58	Truall	127.5		127.5	127.5	25	189			0	127.50	4242	540855				466			11912608.9		12453463.9	Shpërtim e depozituar me ref 00006720 me kodin nr. - 13.03.2014 dt. 12.2.2014 dt. D. Kambur i be rezervuar për 30 ditë me kodin nr. - 25765 datë 17.03.2014, në L.V. anëtarë të be rezervuar për 30 ditë.	
699	1098	Bukllim	Fozulla	Mali	Kashar	2105	978/52	Atë	78		78		23	141	78.00	448	34944							0					34944	Konf. ASHK.	
700	1099	Bukllim	Fozulla	Mali	Kashar	2105	978/48	Atë	153		153		23	109	153.00	448	68544							0					68544	Konf. ASHK.	

Viti 2024 – Numri 49

[illegible]



VENDIM

Nr. 144, datë 13.3.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE
PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E
MIRATIMIT PËR NDËRTIMIN DHE
PËRDORIMIN E TUBACIONEVE E TË
INFRASTRUKTURËS SË SISTEMEVE TË
GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, me propozimin zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtyre rregullave është të përcaktojnë procedurat dhe kriteret për aplikimin, vlerësimin dhe dhënien e një miratimi për ndërtimin e përdorimin e tubacioneve dhe të infrastrukturës përkatëse për transmetimin e shpërndarjen e gazit natyror ose për lidhjen e sistemit shqiptar të gazit natyror me sistemet fqinje, të instalimeve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL-së), të depozitave nëntokësore të gazit natyror, si dhe të linjave direkte.

**Neni 2
Përkufizimet**

Të gjithë termat e përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat në vijim do të kenë këto kuptime:

1. “Autorizim i përkohshëm”, miratimi i ndërmjetëm, i dhënë nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet për vazhdimin e procedurave për marrjen e një miratimi për ndërtimin e përdorimin e tubacioneve dhe të infrastrukturës përkatëse për transmetimin e shpërndarjen e gazit natyror ose për lidhjen e sistemit shqiptar të gazit natyror me

sistemet fqinje, të instalimeve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL-së), të depozitave nëntokësore të gazit natyror, si dhe të linjave direkte.

2. “Subjekt”, një shoqëri aksionare, e krijuar sipas legjislacionit shqiptar ose një zyrë përfaqësie e një shoqërie të huaj aksionare, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, apo një bashkim shoqërisht që aplikon për një miratim, në përputhje me dispozitat e këtij vendimi.

3. “Bashkim shoqërisht”, bashkimi i përkohshëm i dy ose më shumë shoqërive, që paraqesin një kërkesë të përbashkët për marrjen e një miratimi, sipas dispozitave të këtij vendimi.

4. “Miratim”, vendimi i miratuar nga Këshilli i Ministrave, sipas procedurave të këtij vendimi për ndërtimin e tubacioneve dhe të infrastrukturës përkatëse për transmetimin e shpërndarjen e gazit natyror ose për lidhjen e sistemit shqiptar të gazit natyror me sistemet fqinje, të instalimeve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL-së), të depozitave nëntokësore të gazit natyror, si dhe të linjave direkte, i cili bëhet efektiv me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave.

5. “Kontratë”, marrëveshja që lidhet ndërmjet ministrit përgjegjës për energjinë ose i autorizuari prej tij dhe subjektit që ka aplikuar për një miratim, sipas këtij vendimi, për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës përkatëse për transmetimin e shpërndarjen e gazit natyror ose për lidhjen e sistemit shqiptar të gazit natyror me sistemet fqinje, të instalimeve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL-së), të depozitave nëntokësore të gazit natyror, si dhe të linjave direkte, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe i bashkëlidhet miratimit.

6. “Subjekt shtetëror”, çdo shoqëri aksionare që aplikon për një leje, në përputhje me dispozitat e kreut IV, të këtij vendimi, e cila është krijuar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, aksionet e së cilës zotërohen plotësisht nga shteti.

**Neni 3
Miratimi i veçantë për subjektet e
interesuara**

Subjektet e interesuara për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës përkatëse për transmetimin e shpërndarjen e gazit



natyror ose për lidhjen e sistemit shqiptar të gazit natyror me sistemet fqinje, të instalimeve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL-së), të depozitave nëntokësore të gazit natyror, si dhe të linjave direkte, që në vazhdim do të quhen infrastruktura e sistemit të gazit, pajisen me miratim të veçantë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.

KREU II RREGULLAT PËR KUSHTET E DHËNIES SË MIRATIMIT

Neni 4

Rregullat për subjektet

1. Çdo subjekt i themeluar në formën e shoqërisë aksionare, si dhe çdo bashkim i shoqërive, që zhvillon veprimtari tregtare sipas legjislacionit shqiptar, mund të aplikojë për marrjen e një miratimi për ndërtimin e përdorimin e infrastrukturës së sistemeve të gazit, në përputhje me rregullat që përcaktohen në këtë vendim, si dhe duke respektuar edhe kriteret e mosdiskriminimit, të trajtimit të barabartë e të transparencës.

2. Çdo subjekt i huaj, që kërkon të paraqesë kërkesën për marrjen e një miratimi, sipas këtyre rregullave, duhet të krijojë në Shqipëri një filial, në formën e shoqërisë aksionare ose bashkimi të shoqërive, sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe kërkesave të legjislacionit tatimor shqiptar.

Neni 5

Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese

1. Kërkesa për pajisjen me miratim për ndërtimin dhe përdorimin e infrastrukturës së sistemeve të gazit paraqitet në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, e shoqëruar me dokumentet dhe të dhënat e mëposhtme:

a) dokumentin për regjistrimin e subjektit juridik si shoqëri aksionare, të lëshuar nga organi ose institucioni shtetëror, i ngarkuar me ligj;

b) adresën e shoqërisë;

c) dokumentin për numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS);

ç) emrin e administratorit të shoqërisë;

d) vërtetime për shlyerjen e taksave për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe që shoqëria nuk është në proces falimentimi;

dh) vërtetime që shoqëria nuk është dënuar ndonjëherë për shkelje të bëra gjatë veprimtarisë së saj, lëshuar nga organet përkatëse të shteteve, ku ajo ka ushtruar veprimtarinë;

e) pasqyrat financiare të audituara të 3 (tre) vjetëve të fundit të veprimtarisë ose kur shoqëria ka më pak se 3 (tre) vjet që është krijuar për periudhën e ekzistencës së shoqërisë, si dhe çdo dokumentacion tjetër financiar që provon aftësitë financiare për të realizuar projektin e propozuar. Në rastin kur subjekti kërkues ka më pak se 3 (tre) vjet që është krijuar, aksionarët ose partnerët e një subjekti të tillë, që zotërojnë 5% ose më shumë të kapitalit të vet të këtij subjekti, do të paraqesin pasqyra financiare të audituara për secilin prej 3 (tre) vjetëve të fundit, përpara paraqitjes së kërkesës;

ë) një përmbledhje me treguesit kryesorë teknikë, teknologjikë dhe financiarë të projektit të propozuar për ndërtimin dhe përdorimin e infrastrukturës përkatëse për transmetimin e shpërndarjen e gazit natyror ose për lidhjen e sistemit shqiptar të gazit natyror me sistemet fqinje, të instalimeve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL-së), të depozitave nëntokësore të gazit natyror, si dhe të linjave direkte, si dhe të instalimeve të tjera, në funksion të këtyre objekteve;

f) skemidenë, genplanin dhe dokumentet e pronësisë mbi tokën për statusin aktual të pasurisë, të lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, apo çdo dokument tjetër që vërteton formën e përdorimit të kësaj prone (pronësi, qira etj), shoqëruar me aktin përkatës të pronësisë, në rastin kur objekti kërkohet të ndërtohet në zonë të miratuara, sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave, si dhe në zonë të tjera, të përcaktuara sipas studimeve të miratuara me vendime të organeve ose të institucioneve respektive. Në këtë rast, do të ndiqen procedurat e mëposhtme:

i. kur infrastruktura përkatëse e sistemeve të gazit do të ndërtohet në territore në brendësi të vendit (tokë dhe det), nevojiten skemidet dhe genplani i sipërfaqes, ku parashikohet të ndërtohet objekti, së bashku me përditësimet paraprake



teknike dhe administrative;

ii. kur infrastruktura përkatëse e sistemeve të gazit është pjesë e tubacioneve që kalojnë tranzit në territorin e Republikës së Shqipërisë (në më shumë se dy vende në tokë dhe det), nevojiten skemideja dhe genplani i sipërfaqes, ku parashikohet të ndërtohet objekti, të shoqëruara me një skemë tërësore të të gjithë shtrirjes së objektit në vendet e tjera të rajonit, së bashku me përditësimet paraprake teknike dhe administrative, sipas situatës në terren për territorin shqiptar. Pjesë e dokumentacionit të jetë edhe praktika procedurale, që disponon subjekti për marrëveshjen ose miratimin në parim të projektit me vendet e tjera, në territoret e të cilave parashikohet të kalojnë tubacionet e infrastruktura përkatëse për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror ose për lidhjen e sistemit shqiptar të gazit natyror me sistemet fqinje, si dhe linjat direkte.

g) raport i vëzhgimit arkeologjik, i hartuar nga një subjekt me licencën përkatëse në arkeologji, për zonën e propozuar të zhvillimit;

gj) dokumentacionin që vërteton përvojën e subjektit, të filialit ose të kontraktorit të tij, në fushën e ndërtimit ose të përdorimit të infrastrukturës përkatëse të sistemeve të gazit. Nëse subjekti kërkues synon të përdorë në operimet e tij të përditshme një shoqëri menaxhimi, ai duhet të njoftojë për këtë synim ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe të garantojë performancën e kësaj shoqërie;

h) dokumente ose marrëveshje me institucionet bankare, që vërtetojnë kredibilitetin financiar për mundësinë e ndërtimit të infrastrukturës së sistemeve të gazit, referuar objektit që paraqitet në projekte.

2. Kërkesa për një miratim, sipas këtyre rregullave, mund të bëhet edhe nga më shumë se një subjekt, në formën e një bashkimi shoqërisht. Në rast se një aplikim është paraqitur nga një bashkim shoqërisht, anëtarët e këtij bashkimi caktojnë një partner udhëheqës, i autorizuar nëpërmjet një prokure të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e bashkimit për të vepruar në emër të tyre për qëllimin e aplikimit. Dokumentet dhe informacioni i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, duhet të paraqiten për të gjithë anëtarët e bashkimit të shoqërisë. Ministria përgjegjëse për hidrokarburet kërkon në këtë rast dokumenta-

cionin e nevojshëm juridik, ku përcaktohet përgjegjësia solidare e bashkimit të përkohshëm të shoqërive për realizimin e projektit, në formën e një deklarate ose të një marrëveshjeje të përbashkët të shoqërive. Në rastin kur një kërkesë për miratim e bërë nga një bashkim shoqërisht miratohet sipas dispozitave të këtyre rregullave, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit, shoqëritë anëtare të këtij bashkimi krijojnë një shoqëri aksionare, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, me përqindjet përkatëse të aksioneve.

3. Çdo kërkesë e shoqëruar me dokumentacionin përkatës do të paraqitet në gjuhën shqipe në dy kopje: një origjinale ose fotokopje e noterizuar dhe një fotokopje tjetër e të gjithë dokumentacionit të përcaktuar në këto rregulla. Vërtetimet dhe deklaratat nga organet përkatëse, të parashikuara në këto rregulla, duhet të jenë lëshuar jo më parë se 3 (tre) muaj nga çasti i paraqitjes së aplikimit.

4. Kërkesa për dhënien e miratimit, e cila nuk ka bashkëlidhur dokumentacionin e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, nuk është objekt i shqyrtimit nga komisioni i vlerësimit të kërkesave.

KREU III RREGULLAT PËR PROCEDURËN E DHËNIES SË MIRATIMIT

Neni 6 Komisioni *ad hoc*

1. Për vlerësimin e kërkesave dhe të dokumentacionit shoqëruar, të paraqitura nga subjektet e interesuara për t'u pajisur me miratim për ndërtimin e përdorimin e infrastrukturës së sistemeve të gazit pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë, krijohet një komision vlerësimi *ad hoc*, me këtë përbërje:

- a) ministria përgjegjëse për energjinë, 3 anëtarë;
- b) ministria përgjegjëse për zhvillimin e territorit, 1 anëtar;
- c) ministria përgjegjëse për financat, 1 anëtar;
- ç) ministria përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin, 2 anëtarë;
- d) ministria përgjegjëse për kulturën, 1 anëtar;
- dh) ministria përgjegjëse për ekonominë, 1 anëtar.

2. Anëtarët e komisionit caktohen nga



ministrat përkatës. Kryetar i komisionit është një nga anëtarët e ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe caktohet nga ministri përgjegjës për energjinë.

Neni 7

Funksionimi i komisionit dhe procedura për dhënien e miratimit

1. Mënyra e funksionimit të komisionit të vlerësimit të kërkesave përcaktohet me një urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë, i cili duhet të dalë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ministria përgjegjëse për energjinë, në procesin e vlerësimit të një kërkesë, mund të kërkojë ekspertizë dhe konsulencë nga ekspertë/institucione vendase ose të huaja.

3. Komisioni i vlerësimit të kërkesave mbledhet brenda një periudhe kohore 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e paraqitjes së kërkesës dhe bën vlerësimin e saj, duke bërë verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti kërkuar, si më poshtë vijon:

a) kur pas verifikimit, rezulton se dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi është i rregullt, komisioni pranon kërkesën dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve bën vlerësimin e saj, duke i paraqitur ministrit përgjegjës për energjinë praktikën me dokumentacionin përkatës për dhënien subjektit aplikues të “autorizimit të përkohshëm” për vazhdimin e procedurave për plotësimin e dokumentacionit teknik dhe ekonomik për projektin në zonën dhe sipërfaqen e kërkuar, si dhe për realizimin e praktikave përkatëse, deri në marrjen e miratimit. Autorizimi i përkohshëm jepet me afat të përcaktuar dhe titullari i tij duhet të paraqesë kërkesën, sipas dispozitave të këtij vendimi, për pajisjen me miratimin përfundimtar, përpara përfundimit të afatit të autorizimit të përkohshëm;

b) kur pas verifikimit rezulton se dokumentacioni i paraqitur nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 5, të këtij vendimi, komisioni refuzon kërkesën, informon ministrin përgjegjës për energjinë dhe brenda 10 (dhjetë) ditëve ia kthen subjektit kërkuar dokumentacionin përkatës, së bashku me një shkresë, ku argumentohet vendimi i marrë. Subjekti ka të drejtën e riaplikimit;

c) kur subjekti kërkuar nuk është dakord me

vendimin e komisionit, ai ka të drejtën e ankimit brenda 1 (një) muaji nga data e marrjes së vendimit pranë ministrit përgjegjës për energjinë. Shqyrtimi i ankimit dhe vendimi për të jepen brenda 10 (dhjetë) ditëve dhe ky vendim është përfundimtar;

ç) në rast se gjatë shqyrtimit të një kërkesë për një projekt të infrastrukturës së shtetit të gazit, sipas dispozitave të këtyre rregullave, një subjekt tjetër paraqet një kërkesë, e cila i referohet po atij projekti ose një projekti që esencialisht ka të njëjtat parametra hapësinorë, teknike dhe të njëjtat tregues ekonomik me projektin në shqyrtim, kërkesa e dytë nuk merret në shqyrtim nga ministria përgjegjëse për energjinë, nëse nuk është marrë një vendim përfundimtar për pranimin ose jo të kërkesës së parë. Ministria njofton subjektin e dytë kërkuar për vendimin brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tij.

4. Në autorizimin e përkohshëm, të dhënë sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të këtij neni, duhet të përcaktohen:

a) emri i shoqërisë që paraqet kërkesën, numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS);

b) e drejta për të investuar për përgatitjen e dokumentacionit të plotë në zonën përkatëse, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për marrjen e miratimit nga Këshilli i Ministrave;

c) dokumentacioni i nevojshëm që duhet të përgatisë/plotësojë subjekti deri në paraqitjen e tij në ministrinë përgjegjëse për energjinë, për procedim të mëtejshëm për marrjen e miratimit;

ç) afati kohor i vlefshmërisë së autorizimit të përkohshëm, brenda të cilit duhet të përfundojë përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e miratimit, afat i cili në çdo rast nuk mund të jetë më shumë se 2 (dy) vjet.

5. Subjekti i pajisur me autorizimin e përkohshëm duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për energjinë, brenda afatit të përcaktuar në atë autorizim, dokumentacionin e plotë për marrjen e miratimit, i cili duhet të përmbajë:

a) studimin urbanistik për ndërtimin e infrastrukturës së sistemeve të gazit;

b) skemën kryesore me treguesit teknikë dhe ekonomikë të projektit, të miratuar nga institucionet e linjës dhe ekspertë të fushës, vendas apo të huaj, si dhe planbiznesin e përgatitur nga subjekti;

c) dokumentacionin juridik dhe teknik, që



vërtetohet arritjen e ndonjë marrëveshjeje, në parim ose përfundimtare, për projektin që subjekti mund të ketë lidhur me autoritetet përgjegjëse të vendeve të tjera, në territoret e të cilave parashikohet të kalojë tubacioni për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror ose për lidhjen e sistemit shqiptar të gazit natyror me sistemet fqinje, si dhe linja direkte, për rastin kur këto objekte janë pjesë e tubacioneve që kalojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë (në më shumë se dy vende në tokë dhe në det), si dhe një skemë tërësore e objektit të ri për të gjithë shtrirjen e tij në vendet e tjera të rajonit, ku parashikohet të ndërtohet objekti;

ç) dokumentin që vërtetohet të drejtën e pronësisë dhe formën e përdorimit të sipërfaqes së tokës ku do të ndërtohet objekti, për një periudhë të barabartë me afatin e miratimit;

d) lejen mjedisore përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, të dhënë nga ministria përgjegjëse për mjedisin;

dh) miratimin për zhvillimet transformuese në territor (rrugë, autostrada, aeroporte, porte, vepra industriale, qendra të reja banimi, vepra të tjera, si edhe për çdo transformim të territorit, duke përfshirë projektet minerare, në pronësi shtetërore ose private), në përputhje me legjislacionin për trashëgiminë kulturore;

e) dokumentacionin bankar që vërtetohet aftësinë financiare të shoqërisë për të përballuar ndërtimin e tubacionit ose të infrastrukturës së gazit;

ë) opinionin e ERE-s, në rast se nga subjekti është kërkuar ose do të kërkohej të merret një licencë dhe/ose miratimi për përjashtimin nga aksesimi i palës së tretë për infrastrukturën e sistemeve të gazit, që kërkohej të ndërtohet dhe të përdoret prej tij, sipas dispozitave të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar. Opinioni i ERE-s nuk është i nevojshëm në rastin e ndërtimit të një linje direkte;

f) dokumentacionin dhe praktikat procedurale, që disponon subjekti për marrëveshjet, që ai ka arritur me organet e pushtetit vendor, lidhur me projektin, në rast se në projektin për tubacionet e infrastrukturës përkatëse përfshihet edhe shpërndarja e gazit natyror në territorin që është në juridiksionin e këtyre organeve të pushtetit vendor.

6. Komisioni i vlerësimit, brenda 60 (gjashtë-

dhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së dokumentacionit, të përcaktuar në pikën 5, të këtij neni, shqyrton dokumentacionin dhe i propozon ministrit përgjegjës për energjinë miratimin ose jo të vazhdimin të procedurave për dhënien e miratimit për ndërtimin e përdorimit të objektit konkret të infrastrukturës së sistemeve të gazit.

7. Në rast se komisioni i vlerësimit i propozon ministrit të miratojë vazhdimin e procedurave për dhënien e miratimit dhe ky i fundit shprehet dakord, ministri urdhëron negociimin për lidhjen e kontratës me subjektin që do të marrë të drejtën për ndërtimin e përdorimit të objektit të infrastrukturës së sistemit të gazit. Komisioni i vlerësimit negocion termet dhe kushtet e kontratës me subjektin që do të marrë miratimin. Negociimet e kontratës për dhënien e miratimit duhet të përfundojnë brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga data e paraqitjes së dokumentacionit, të përcaktuar në pikën 5, të këtij neni.

8. Kontrata, e cila nënshkruhet nga ministri përgjegjës për energjinë, së bashku me të gjitha dokumentet e përgatitura, sipas këtij vendimi, dhe me një kopje të autorizimit të përkohshëm, në përputhje me praktikën dhe procedurat ligjore në fuqi, paraqiten në Këshillin e Ministrave për miratimin e lejes, e cila bashkëlidhur ka si pjesë të saj edhe kontratën.

9. Në kontratën e negociuar, sipas pikës 7, të këtij neni, duhet të përcaktohen:

a) palët dhe adresat përkatëse të tyre, përfshirë dhe përfaqësuesin e organit shtetëror, që ndjek dhe monitoron ndërtimin e përdorimit të infrastrukturës së sistemeve të gazit;

b) vendndodhja ose zona e shtrirjes së objektit të infrastrukturës së sistemeve të gazit, përfshirë edhe përcaktimin e kufijve të sektorëve të veçantë të tij;

c) periudha e vlefshmërisë së miratimit, që është 30 (tridhjetë) vjet nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshilli të Ministrave, si dhe e drejta për rinovimin e këtij miratimi nëpërmjet paraqitjes së kërkesës nga subjekti, jo më vonë se 3 (tre) vjet nga përfundimi i afatit të miratimit;

ç) afati i paraqitjes së dokumentacionit për marrjen e miratimit të ndërtimit, afati i përfundimit të ndërtimit të objektit të infrastrukturës së sistemeve të gazit, si dhe i fillimit të vënies në përdorim;

d) e drejta e shoqërisë së pajisur me miratim



për të kërkuar shtyrjen e afatit të përfundimit të ndërtimit ose të vënies në përdorim të objektit të infrastrukturës së sistemeve të gazit, për shkak të një force madhore;

dh) detyrimi i shoqërisë për marrjen e miratimeve dhe të licencave përkatëse nga ERE në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe e drejta e organeve dhe institucioneve shtetërore, të ngarkuara me ligj, për kontrollin e zbatimit të projektit me cilësinë dhe në afatin e përcaktuar në projekt;

e) lloji i produkteve që do të transportohen në objektin e infrastrukturës së sistemeve të gazit;

ë) lloji i të dhënave dhe afatet, brenda të cilave subjekti duhet t’i dërgojë ato në ministrinë përgjegjëse për energjinë;

f) të dhënat dhe informacioni për dokumentacionin e praktikave procedurale, që disponon subjekti për marrëveshjen, lidhur me projektin ose për miratimin e tij në parim nga vendet e tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi në këto vende, në rast se ka parashikim që tubacionet dhe infrastruktura përkatëse për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror ose për lidhjen e sistemit shqiptar të gazit natyror me sistemet fqinje, si dhe linjat direkte të kalojnë në territoret e këtyre vendeve;

g) sanksionet ndaj subjektit deri në përfundimin e njëanshëm të kontratës, në rast të mosfillimit në kohë të punimeve, të ndërprerjes, të heqjes dorë apo të paaftësisë për të realizuar/përfunduar investimin për objektin (projektin), për të cilat më parë ka qenë përcaktuar një periudhë kohore për ndreqjen ose korrigjimin e shkeljeve të vërejtura apo kur nga kontrollet e ushtruara nga organet dhe institucionet shtetërore, të ngarkuara me ligj, janë vërejtur shkelje ose mosrespektim të kërkesave në zbatimin e parametrave teknikë, në afatin e realizimit të projektit dhe të normave mjedisore apo të detyrimeve të tjera ligjore në fuqi gjatë periudhës së përdorimit të objektit, për të cilat më parë ka qenë përcaktuar një periudhë për ndreqjen ose korrigjimin e shkeljeve;

gj) kalimi i të drejtave dhe/ose i detyrimeve të kontratës dhe ndryshimi i aksionarëve të shoqërisë;

h) detyrimi i subjektit për respektimin e

Faqe | 5548

legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe të marrëveshjeve, të konventave apo të traktateve ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është palë;

i) mënyra dhe forma se si do të bëhet transferimi i pronësisë mbi infrastrukturën e gazit nga subjekti te shteti, në rast se miratimi i dhënë nuk kërkohej të ripërtërihet nga ana e subjektit ose nuk ripërtërihet nga ana e Këshillit të Ministrave, sipas dispozitave të këtij vendimi, si dhe në rast të prishjes së njëanshme të kontratës;

j) garancia financiare dhe garancia e performancës nga shoqëria mëmë, që sigurojnë aftësinë e subjektit për të përmbushur detyrimet e tij, të përcaktuara në miratimin e dhënë dhe mbështetjen menaxheriale, operationale dhe financiare të pronarëve të subjektit;

k) detyrimi për lidhjen e siguracionit me shoqëritë e sigurimit, që mbulon përgjegjësinë për dëmet që mund të shkaktojë ndaj jetës dhe shëndetit të personave ose për humbjet a dëmtimet e pasurisë, të shkaktuara nga ose si rezultat i veprimtarive të subjektit, sipas miratimit të kërkuar. Një politikë e tillë siguracioni do të mbetet e vlefshme për të gjithë periudhën e miratimit të kërkuar.

10. Në kontratë, përveç elementeve të përcaktuara në pikën 9, të këtij neni, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, mund të përfshihen edhe përcaktime të tjera ose detyrime të ndërsjella, për të cilat palët bien dakord.

11. Kontrata hartohet në 3 (tri) kopje, nga të cilat 1 (një) kopje i dorëzohet zyrtarisht subjektit, të cilit i jepet miratimi, dhe 2 (dy) kopje i dërgohen ministrisë përgjegjëse për energjinë.

12. Në rast mosmiratimi nga Këshilli i Ministrave të miratimit, kontrata e negociuar, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 7, të këtij neni, konsiderohet e pavlefshme dhe kërkesa për miratim konsiderohet e refuzuar.

Neni 8

Dhënia e miratimit

1. Miratimi bëhet efektiv me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave.

2. Dhënia e miratimit për ndërtimin dhe përdorimin e infrastrukturës së sistemeve të gazit bëhet kundrejt një pagese prej:

a) 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, për



projektet, vlera totale e investimit të të cilave arrin deri në 100 000 000 (njëqind milionë) lekë;

b) 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për projektet, vlera totale e investimit të të cilave është nga 100 000 000 (njëqind milionë) deri në 300 000 000 (treqind milionë) lekë;

c) 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh, për projektet, vlera totale e investimit të të cilave është mbi 300 000 000 (treqind milionë) lekë.

3. Pagesat e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, bëhen nga subjekti mbajtës i miratimit, për llogari të buxhetit të shtetit.

4. Subjekti i pajisur me miratimin për ndërtimin dhe përdorimin e infrastrukturës së sistemeve të gazit kryen edhe të gjitha pagesat e tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për marrjen e miratimeve dhe të autorizimeve të nevojshme për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë.

Neni 9

Përgjegjësia e institucioneve përgjegjëse

Ministrat, që drejtojnë ministrinë e përcaktuara në nenin 6, të këtij vendimi, do të jenë përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave, që do të ndjekin dhe do të monitorojnë realizimin e kontratës së miratimit të dhënë për ndërtimin e përdorimin e infrastrukturës së sistemeve të gazit, sipas përmbajtjes së miratuar me vendimin përkatës nga Këshilli i Ministrave. Monitorimi administrativ dhe tekniko-financiar i realizimit të kërkesave të kontratës së miratimit do të bëhet nga një grup teknik, i përbërë nga përfaqësues të ministrive, të përcaktuara në nenin 6, të këtij vendimi, dhe i miratuar nga ministrat përkatës.

Neni 10

Veprime të tjera të subjekteve

1. Kryerja e pagesave për ndërtimin dhe përdorimin e infrastrukturës së sistemeve të gazit, shlyerja e detyrimeve të tjera kontraktore, si dhe çdo detyrim doganor dhe fiskal për këto veprimtari bëhen nëpërmjet dokumentacionit bankar.

2. Veprimtaria e subjekteve, të pajisura me miratimin për ndërtimin dhe përdorimin e infrastrukturës së sistemeve të gazit monitorohet nga strukturat e ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe nga institucione e struktura të tjera

shtetërore, të ngarkuara me ligji.

Neni 11

Rinovimi i miratimit

Çdo rinovim i miratimit, e kërkuar nga subjekti mbajtës, sipas shkronjës “c”, të pikës 9, të nenit 7, e shoqëruar me kontratën përkatëse, miratohet nga Këshilli i Ministrave, vetëm nëse opinioni i ERE-s, sipas shkronjës “e”, të pikës 5, të nenit 7, është pozitiv dhe nëse subjekti mbajtës i kësaj ka përmbushur të gjitha detyrimet e përcaktuara në kontratë dhe/ose detyrimet e tjera ligjore gjatë gjithë periudhës së miratimit.

KREU IV

RREGULLAT PËR PROCEDURËN E DHËNIES SË LEJES PËR SUBJEKTET SHTETËRORE

Neni 12

Dhënia e lejes për subjektet shtetërore

1. Procedura e dhënies së lejes për subjektet shtetërore është sipas këtij kreu.

2. Aplikimi për leje bëhet nga subjekti shtetëror në ministrinë përgjegjëse për energjinë, vetëm pasi të jetë realizuar në respektim të parashikimeve të ligjit për prokurimin publik përgatitja e projektit përfundimtar të ndërtimit.

3. Aplikimi për leje nga subjekti shtetëror shoqërohet nga projekti përfundimtar dhe informacioni i detajuar për projektin.

4. Ministria propozon në Këshillin e Ministrave miratimin për ndërtimin e tubacionit dhe infrastrukturës së gazit natyror nga subjekti shtetëror, në përputhje me pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

5. Çdo aplikim për leje, sipas këtij neni, duhet të shoqërohet me lejen mjedisore përkatëse të dhënë nga ministria përgjegjëse për mjedisin, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU V



DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13
Shfuqizime

Vendimi nr. 713, datë 25.8.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për kushtet e procedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror”, shfuqizohet.

Neni 14
Institucionet që ngarkohen për zbatimin e vendimit

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi RamaVENDIM
Nr. 145, datë 13.3.2024PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Rajmonda Balilaj, prefekt i qarkut të Fierit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi RamaVENDIM
Nr. 146, datë 13.3.2024PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË VLORËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Flamur Mamaj, prefekt i qarkut të Vlorës, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Vangjel Tavo emërohet prefekt i qarkut të Vlorës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi RamaVENDIM
Nr. 147, datë 13.3.2024PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.
1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË
VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË
BASHKIMIT EVROPIAN PËR
VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE
SHFUQIZIMIN E MASAVE
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE,
TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 3, të kreut I, pas fjalëve “...(CFSP) 2023/2231...” shtohen “... (CFSP) 2024/333 ...”.

2. Në aneksin 3, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2024/333, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat

shtrenguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në pikën 1, të nenit 7, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Fletorja Zyrtare
e Bashkimit Evropian

SHQIP
Seria L

2024/333

16.1.2024

VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2024/333

më 16 janar 2024

për ndryshimin e Vendimit (CFSP) 2016/1693 në lidhje me masat kufizuese kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaeda dhe personat, grupet, ndërmarrjet dhe subjektet e lidhura me to

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe specifikisht nenin 29 ,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë ,

- (1) Më 20 shtator 2016, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2016/1693⁽¹⁾.
- (2) Duke pasur parasysh kërcënimin e vazhdueshëm të paraqitur nga ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaeda dhe personat, grupet, ndërmarrjet dhe subjektet e lidhura me to, një person duhet t'i shtohet listës së personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe subjekteve të përcaktuara në Shtojcën e Vendimit (CFSP) 2016/1693. Për më tepër, regjistrimi për një person të vdekur duhet të fshihet nga kjo Shtojcë.
- (3) Prandaj, Vendimi (CFSP) 2016/1693 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Shtojca e Vendimit (CFSP) 2016/1693 është ndryshuar në përputhje me Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Lëshuar në Bruksel, 16 janar 2024.

*Për Këshillin
Presidenti*

V. VAN PETEGHEM

⁽¹⁾ Vendimi i Këshillit (CFSP) 2016/1693 i datës 20 shtator 2016 në lidhje me masat kufizuese kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaeda dhe personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe subjekteve të lidhura me to dhe shfuqizimin e Vendimit të Përbashkët 2002/402/CFSP (OJ L 25 ,21.9.2016, f. 25).



SHQIP

OJ L, 16.1.2024

ANEKSI

Në Shtojcën e Vendimit (CFSP) 2016/1693, paragrafi A (Personat e përmendur në nenet 2 dhe 3) është ndryshuar si vijon:

- (1) regjistrimi 16 (Bonomade Machude OMAR) është fshirë;
- (2) shtohet regjistrimi i mëposhtëm:

'17. Andreas Martin MÜLLER (i njohur ndryshe si Ahmed Khaled Müller, Abu Nusaibah, Abu Nusaiba, Ebu Nussaiba, Miqdad, Abu Miqdad, Yasser Murat, Mr Akam, Abu Shahid, Nigeri); data e lindjes: 15 shkurt 1972; vendi i lindjes: Cochem, Rhineland-Pfalz, Gjermani; Gjinia mashkull; kombësia: gjermane; numri i pasaportës: C73TV06C9; letërnjoftimi nr: 5210375966.'



2024/333

16.1.2024

COUNCIL DECISION (CFSP) 2024/333

of 16 January 2024

amending Decision (CFSP) 2016/1693 concerning restrictive measures against ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 20 September 2016, the Council adopted Decision (CFSP) 2016/1693 ⁽¹⁾.
- (2) In view of the continued threat posed by ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them, one person should be added to the list of persons, groups, undertakings and entities set out in the Annex to Decision (CFSP) 2016/1693. Additionally, the entry concerning one deceased person should be deleted from that Annex.
- (3) Decision (CFSP) 2016/1693 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The Annex to Decision (CFSP) 2016/1693 is amended in accordance with the Annex to this Decision.

*Article 2*This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 16 January 2024.

For the Council
The President
V. VAN PETEGHEM

⁽¹⁾ Council Decision (CFSP) 2016/1693 of 20 September 2016 concerning restrictive measures against ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them and repealing Common Position 2002/402/CFSP (OJ L 255, 21.9.2016, p. 25).



EN

OJ L, 16.1.2024

ANNEX

In the Annex to Decision (CFSP) 2016/1693, section A (Persons referred to in Articles 2 and 3) is amended as follows:

(1) entry 16 (Bonomade Machude OMAR) is deleted;

(2) the following entry is added:

- ‘17. Andreas Martin MÜLLER (a.k.a. Ahmed Khaled Müller, Abu Nusaibah, Abu Nusaiba, Abu Nussaiba, Miqdad, Abu Miqdad, Yasser Murat, Mr Akam, Abu Shahid, Nigeri); date of birth: 15 February 1972; place of birth: Cochem, Rhineland-Palatinate, Germany; gender: male; nationality: German; passport number: C73TV06C9; identity card number: 5210375966.’.

**VENDIM****Nr. 148, datë 13.3.2024****PËR KRITERET DHE PROCEDURAT
PËR HAPJEN, MBYLLJEN DHE
RIORGANIZIMIN E INSTITUCIONEVE
TË ARSIMIT SPECIAL NË QENDRA
BURIMORE, SI DHE PËR MËNYRËN E
ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT
TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 64/1, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për hapjen, mbylljen e qendrave burimore, si dhe riorganizimin e institucioneve të arsimit special në qendra burimore.

2. Përcaktimin e mënyrës së organizimit dhe të funksionimit të Qendrës Burimore.

3. Qendra Burimore është institucion arsimor publik, në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

4. Qendra Burimore ofron arsim special në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar dhe, sipas specifikës, edhe arsim special parashkollor.

5. Qendra Burimore ofron arsim special parauniversitar për nxënësit me aftësi të kufizuar dëgjimi, me aftësi të kufizuar shikimi dhe ato me aftësi të kufizuar të rëndë, që kërkojnë një mbështetje në qendra të specializuara për t'i përfshirë në sistemin arsimor të zakonshëm.

6. Qendra Burimore ofron shërbime të veçanta mbështetëse dhe rehabilituese për nxënësit me aftësi të kufizuar që mësojnë në shkolla të zakonshme, si dhe trajnime për punonjësit arsimorë që punojnë me këta nxënës.

7. Hapja e një qendre burimore është procesi i ngritjes dhe i funksionimit për herë të parë të saj.

8. Riorganizimi i një institucioni të arsimit special në qendër burimore është procesi i zgjerimit dhe i shtrirjes së aktivitetit të tij përtej arsimit special, duke ofruar shërbime mbështetëse dhe rehabilituese të specializuara për nxënësit me aftësi të kufizuar edhe

në shkolla të zakonshme, si dhe trajnime për punonjësit arsimorë.

9. Hapja dhe mbyllja e qendrave burimore, si dhe riorganizimi i institucioneve të arsimit special në qendra burimore bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

**II. KRITERET PËR HAPJEN DHE
MBYLLJEN E QENDRAVE BURIMORE DHE
RIORGANIZIMIN E INSTITUCIONEVE TË
ARSIMIT SPECIAL NË QENDRA BURIMORE**

1. Hapja e Qendrës Burimore për nxënësit me aftësi të kufizuar bëhet kur përmbushen këto kriterë:

a) Ndërtesa dhe mjediset e saj plotësojnë kushtet infrastrukture, sipas akteve nënligjore në fuqi, që përcaktojnë standardet e projektimit të shkollave dhe rregullat për shfrytëzimin e hapësirave nga persona me aftësi të kufizuar.

i. siguron mjedise që plotësojnë kushtet për të ofruar arsim special dhe përshtatje të arsyeshme për nxënësit me diagnoza të veçanta dhe ata me aftësi të kufizuar të rëndë;

ii. siguron mjedise për mbështetjen e nxënësve me aftësi të kufizuar që mësojnë në shkolla të zakonshme;

iii. siguron mjedise rekreative për socializimin, motivimin, mbështetjen dhe zhvillimin e prirejeve të veçanta të nxënësve me aftësi të kufizuar.

b) Drejtuesit, stafi mësimor i specializuar dhe stafi mbështetës plotësojnë kriteret profesionale përkatëse.

2. Institucioni i arsimit special riorganizohet në qendër burimore, kur plotëson këto kriterë:

a) ndërtesa dhe mjediset e saj plotësojnë kushtet infrastrukture, sipas akteve nënligjore për standardet e projektimit të shkollave dhe rregullat për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar, për të siguruar arsim special, përshtatje të arsyeshme, sipas nevojës, dhe shërbime të specializuara për nxënësit me aftësi të kufizuar;

b) siguron për një periudhë kohore, jo më pak se 5 (pesë) vjet shkollorë arsim special dhe shërbime të specializuara arsimore për një grupim të veçantë të nxënësve me aftësi të kufizuar, nxënës që nuk dëgjojnë, nxënës që nuk shikojnë, nxënës me aftësi të kufizuar të rëndë e diagnoza të shumëfishta;

c) drejtuesit, stafi mësimor, stafi i specializuar dhe stafi mbështetës plotësojnë kriteret profesionale përkatëse.

3. Mbyllja e Qendrës Burimore bëhet në rastet, si më poshtë vijon:



a) nuk përmbushet më, të paktën njëri prej kriterëve të hapjes;

b) frekuentimi i institucionit dhe shërbimet mbështetëse e rehabilituese për nxënësit me aftësi të kufizuar në arsimin e zakonshëm janë në rënie për të paktën 3 (tre) vjet radhazi dhe vlerësohet joeficiente mbajtja e tyre.

III. PROCEDURAT PËR HAPJEN DHE MBYLLJEN E QENDRAVE BURIMORE DHE RIORGANIZIMIN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT SPECIAL NË QENDRA BURIMORE

A. Hapja e qendrave burimore

1. Propozimi për hapjen e qendrave burimore mund të merret nga:

a) njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore (në vijim “NJVV”);

b) Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (në vijim “AKAP”), sipas nevojave dhe kërkesave të institucioneve të saj të varësisë.

2. Kur nisma për hapjen e qendrës burimore merret nga NJVV-ja, ku do të hapet qendra burimore, NJVV-ja pas sigurimit të infrastrukturës së nevojshme për ngritjen apo funksionimin e qendrës burimore dhe vlerësimit të nevojës në territorin e saj për këto shërbime, i paraqet kërkesën me shkrim Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.

3. AKAP-ja, pasi verifikon dokumentacionin shoqërues për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara, përcjell për miratim në ministrinë përgjegjëse për arsimin propozimin për hapje të Qendrës Burimore.

4. Në rastet kur propozimi për hapje bëhet nga AKAP-ja, kjo e fundit, pasi vlerëson nevojat, kapacitetet dhe plotësimin e kriterëve të përcaktuara për hapjen e qendrës burimore aplikon sipas afateve në ministrinë përgjegjëse për arsimin me dokumentacionin përkatës, sipas këtij vendimi, pasi ka marrë më parë miratimin e NJVV-së përkatëse për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme.

5. Propozimi për hapjen e një qendre burimore paraqitet jo më vonë se:

a) 3 (tre) muaj para fillimit të vitit shkollor, kur institucioni hapet në një godinë ekzistuese;

b) 1 (një) vit kalendarik para fillimit të vitit shkollor, kur nevojitet godinë e re.

B. Riorganizimi i qendrave burimore

1. Propozimi për riorganizimin e një institucioni publik të arsimit special në qendër burimore merret nga vetë institucioni dhe ndjek këto procedura:

a) drejtuesi i institucionit të arsimit special, që është nën juridiksionin e ministrisë përgjegjëse për arsimin, nëpërmjet AKAP-së paraqet në ministrinë përgjegjëse për arsimin propozimin për riorganizimin e institucionit në qendër burimore;

b) kërkesa me shkrim paraqitet jo më vonë se 3 (tre) muaj para fillimit të vitit shkollor.

2. Propozimi për riorganizimin e institucionit të arsimit special në qendër burimore shoqërohet me këto dokumente:

a) argumentimin e domosdoshmërisë së riorganizimit të institucionit të arsimit special në qendër burimore;

b) Planin strategjik 3-vjeçar të zhvillimit të Qendrës Burimore, ku përfshihen standardizimi i shërbimeve arsimore, rehabilituese dhe integruese, plani i zhvillimit të kapaciteteve të stafit mësimor dhe personelit të specializuar dhe ndihmës dhe plani i aktiviteteve arsimore, mbështetëse, trajtuese dhe integruese të qendrës dhe bashkëpunimi me strukturat vendore dhe ato të specializuara arsimore;

c) miratimin e NJVV-së për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për riorganizimin e institucionit të arsimit special në qendër burimore;

ç) të dhëna për përmbushjen e kriterëve të parashikuara në kreun II, të këtij vendimi.

C. Mbyllja e qendrave burimore

1. Propozimi për mbylljen e një qendre burimore paraqitet jo më vonë se 3 (tre) muaj para fillimit të vitit shkollor.

2. Nisma për mbylljen e Qendrës Burimore mund të merret nga:

a) NJVV-ja;

b) AKAP-ja, bazuar në vlerësimin e bërë nga strukturat në varësi të saj.

3. Propozimi për mbylljen e Qendrës Burimore shoqërohet me këto dokumente:

a) argumentimin e mosplotësimit më të kushteve të hapjes, qëllimit dhe funksionimit të Qendrës Burimore;

b) planin e transferimit të nxënësve të institucionit që do të mbyllet në një qendër burimore tjetër apo drejt institucioneve të arsimit parauniversitar, të mbështetur nga mësues ndihmës;

c) Përcaktimin e administrimit të inventarit të orendive, mjeteve mësimore etj të Qendrës Burimore.

4. Ministri përgjegjës për arsimin vendos për hapjen dhe mbylljen e Qendrës Burimore, si dhe riorganizimin e një institucioni të arsimit special në



qendër burimore, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga marrja e kërkesës me shkrim apo propozimit nga strukturat përgjegjëse.

IV. MËNYRA E ORGANIZIMIT DHE E FUNKSIONIMIT TË QENDRAVE BURIMORE

1. Qendra Burimore organizohet me disa ose të gjitha njësitë, si më poshtë vijon:

a) Shkollë speciale për nxënës me aftësi të kufizuar;

b) Departamenti i identifikimit dhe vlerësimit të nevojave arsimore të nxënësve me aftësi të kufizuar;

c) Departamenti i përgatitjes së mjeteve didaktike, kurrikulës së përshtatur dhe zhvillimit profesional e trajnimeve të mësuesve;

ç) Departamenti i shërbimeve mbështetëse dhe rehabilituese;

d) Departamenti i edukimit dhe mbështetjes në distancë të nxënësve me aftësi të kufizuar;

dh) Departamenti i kërkimit dhe i zhvillimit;

e) Departamenti i përshtatjes së arsyeshme.

2. Qendra Burimore kryen funksionet, si më poshtë vijon:

a) ofron arsim special, në përputhje me planin mësimor të miratuar nga ana e strukturave përgjegjëse, si dhe kur vlerësohet edhe përshtatje e arsyeshme për nevoja të veçanta të nxënësve me aftësi të kufizuar, sipas kategorive të përcaktuara në këtë vendim;

b) identifikon dhe vlerëson nevojat arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuar të moshës shkollore për zonën që mbulon, duke synuar gjithëpërfshirjen e tyre në arsim;

c) siguron ekspertizën e nevojshme për komisionet multidisiplinare të institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar për të përcaktuar formën e përshtatshme të arsimimit të nxënësve me aftësi të kufizuar dhe procedurat që duhet të ndjekin;

ç) siguron mbështetje të specializuar për komisionet shkollore për hartimin dhe zbatimin e planeve edukative individuale për nxënësit me aftësi të kufizuar në arsimin e zakonshëm;

d) ofron programe përgatitore për t'u përshtatur lehtësisht me institucionin arsimor për nxënës me aftësi të kufizuar që do të fillojnë arsimin;

dh) mbështet arsimimin e vazhduar të nxënësve me aftësi të kufizuar në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, duke hartuar dhe shpërndarë materiale ndihmëse mësimore dhe didaktike për

nxënësit me aftësi të kufizuar, si dhe për mësuesit që punojnë me këta nxënës në shkolla të zakonshme;

e) siguron, pas orarit mësimor, shërbime të specializuara arsimore plotësuese për nxënës me aftësi të kufizuar, që ndjekin shkollat speciale dhe ato të zakonshme për kategoritë e përcaktuara në këtë vendim;

ë) siguron mbështetjen, këshillimin dhe shkëmbimin e përvojave të mësuesve e të mësuesve ndihmës, që punojnë me nxënës me aftësi të kufizuar në shkolla të zakonshme dhe bashkëpunon për trajnimin e vazhduar dhe zhvillimin profesional të tyre;

f) shërben si qendër kërkimore për zhvillimin e teknologjive inovative për të mësuarit e vazhduar, digjital dhe në distancë të nxënësve me aftësi të kufizuar;

g) siguron këshillim dhe mbështetje për aftësimin dhe zhvillimin e kompetencave për jetesë të pavarur të nxënësve me aftësi të kufizuar dhe integrimin e tyre në jetën sociale;

gj) siguron informim, këshillim dhe mbështetje për prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuar për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave specifike të tyre në familje e komunitet;

h) siguron, në partneritet me shoqërinë civile, informimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të qenë pjesë e procesit të hartimit të politikave dhe të vendimmarrjes në mbështetje të tyre;

i) ndjek dhe dokumenton ecurinë e arsimimit dhe të aftësimin për jetesë të pavarur të nxënësve me aftësi të kufizuar, që ndjekin shkollat e zakonshme.

3. AKAP-ja, nëpërmjet institucioneve të saj të varësisë, realizon këto detyra:

a) miraton rregulloren tip të organizimit dhe të funksionimit të Qendrës Burimore dhe përshkrimet e punës, bazuar në strukturën e miratuar;

b) bashkëpunon me institucionin përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe Qendrën Burimore për hartimin, përditësimin dhe ndjekjen e procedurave të miratimit të kurrikulës shkollore të përshtatur për programin mësimor të ofruar në qendër, sipas specifikave dhe ciklit arsimor;

c) koordinon bashkëpunimin mes Qendrës Burimore dhe shkollave të zakonshme për shërbimet arsimore, shërbimet mbështetëse dhe integruese për nxënësit me aftësi të kufizuar;



ç) koordinon veprimtaritë e Qendrës Burimore me institucionet e arsimit parauniversitar lidhur me shkëmbimin e përvojave, këshillimin dhe trajnimin e mësuesve dhe mësuesve ndihmës, që punojnë në shkollat e zakonshme;

d) koordinon veprimtaritë informuese dhe ndërgjegjësuere të Qendrës Burimore për gjithëpërfshirjen në arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara;

dh) monitoron dhe dokumenton aktivitetin e Qendrës Burimore në mbështetje të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe të mësuesve në arsimin e zakonshëm;

ë) bashkëpunon me Qendrën Burimore për standardet e ofrimit të shërbimit nëpërmjet rekrutimit të stafit.

4. Financimi dhe administrimi i veprimtarisë së qendrave burimore realizohet, si më poshtë vijon:

a) me fonde publike nga buxheti i shtetit të ardhura të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, dhurime e sponsorizime, të ardhura të përftuara nga vetë institucionet arsimore, si dhe të ardhura të tjera të ligjshme;

b) me financim nga buxheti i shtetit të planifikuar me formulën “Për nxënës”, sipas treguesve të veçantë të niveleve arsimore dhe aktiviteteve që do të sigurojë institucioni;

c) ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për financat miratojnë hapjen dhe mbylljen e llogarisë buxhetore apo llogarive në bankat e nivelit të dytë të qendrave burimore, të cilat mbajnë llogari buxhetore në degën e thesarit të institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar apo llogari në bankat e nivelit të dytë për të ardhurat e krijuara nga vetë ato;

ç) rregullat e administrimit financiar për llogaritë buxhetore apo llogaritë në bankat e nivelit të dytë përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe të ministrit përgjegjës për financat.

5. Struktura konkrete e organizimit të Qendrës Burimore përcaktohet në aktin përkatës për hapjen/riorganizimin e saj.

6. Për nevoja të qendrës për ofrimin e shërbimeve rehabilituese dhe integruuese, ajo kontraktton me kohë të pjesshme specialistë të fushës përkatëse, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e funksionimit të saj.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Institucionet publike aktuale të arsimit special, të cilat plotësojnë kriteret sipas këtij vendimi, aplikojnë për t'u riorganizuar si qendër burimore për nxënësit me aftësi të kufizuara, duke ndjekur procedurat për riorganizim, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet rajonale përgjegjëse për arsimin parauniversitar, institucionet vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit special për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM Nr. 149, datë 13.3.2024

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË POSAÇME DHE PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E STATUSIT “SHKOLLË ME STATUS TË VEÇANTË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kriterëve të posaçme dhe procedurave për përfitimin e statusit “Shkollë me status të veçantë”, për institucionin arsimor parauniversitar publik (IAPP) i arsimit të orientuar me drejtim artistik apo sportiv.

2. IAPP-ja e arsimit të orientuar me drejtim artistik fiton statusin “Shkollë me status të veçantë” kur ka një kapacitet për jo më pak se 100 (njëqind) nxënës dhe garanton mjediset për zhvillimin e kurrikulës artistike dhe të përgjithshme me



parametrat e mëposhtëm, sipas tipologjive të shkollës, si më poshtë vijon:

a) disponon infrastrukturën e përshtatshme, sipas kuadrit ligjor në fuqi;

b) disponon personel mësimdhënës të arsimit të orientuar, në përputhshmëri me kurrikulën e veçantë artistike;

c) shkolla dhe nxënësit janë vlerësuar me çmime në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare;

ç) institucioni të jetë vlerësuar “Shumë mirë” në vlerësimin e fundit nga strukturat përkatëse për inspektimin dhe vlerësimin e cilësisë;

d) klasat dhe laboratorët të jenë në funksion të mësimdhënies, sipas kurrikulës së miratuar;

dh) disponon jo më pak 2 (dy) salla baleti me standarde bashkëkohore;

e) disponon sallë testimi për kanto/muzikë/instrumente, galeri arti dhe gipsotekë, atelie, sipas specifikave të shkollës, sallë koncertesh;

ë) disponon bibliotekë me tituj librash, sipas specifikave të shkollës;

f) disponon personel të kualifikuar, të licencuar dhe të trajnuar për mësimdhënie në profilet artistike të shkollës;

g) disponon muzeun e shkollës, si dhe fonotekë të pasur të ngjarjeve më të rëndësishme të historisë kombëtare dhe botërore për teatrin dhe kinematografinë.

3. IAPP-ja e arsimit të orientuar me drejtim sportiv fiton statusin “Shkollë me status të veçantë” kur ka një kapacitet për jo më pak se 100 (njëqind) nxënës dhe garanton mjediset për zhvillimin e kurrikulës sportive dhe të përgjithshme me parametrat e mëposhtëm, sipas tipologjive të shkollës, si më poshtë vijon:

a) disponon infrastrukturën e përshtatshme, sipas kuadrit ligjor në fuqi;

b) disponon personel mësimdhënës të arsimit të orientuar, në përputhshmëri me kurrikulën e veçantë sportive;

c) shkolla dhe nxënësit janë vlerësuar me çmime në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare;

ç) institucioni të jetë vlerësuar “Shumë mirë” në vlerësimin e fundit nga strukturat përkatëse për inspektimin dhe vlerësimin e cilësisë;

d) klasat dhe laboratorët të jenë në funksion të mësimdhënies, sipas kurrikulës së miratuar;

dh) disponon jo më pak se 1 (një) terren sportiv të mbuluar dhe 1 (një) terren të hapur, që mbulon disiplinat kryesore sportive;

e) disponon jo më pak se 1 (një) palestër me standarde bashkëkohore për stërvitje për shkollat sportive, të mirëpajisur me mjete sportive;

ë) disponon stafe të certifikuar dhe të licencuara si trajnerë nga federatat shqiptare sportive, sipas disiplinave të shkollës sportive;

f) disponon bibliotekë me tituj librash, sipas specifikave të shkollës;

g) disponon muzeun e shkollës, si dhe fonotekë të pasur të ngjarjeve më të rëndësishme të historisë kombëtare dhe ndërkombëtare në sport;

gj) bazuar në kurrikulën sportive, siguron realizimin e 3 (tri) aktiviteteve sportive në shkallë kombëtare ose ndërkombëtare, në 3 (tre) vjetët e fundit.

4. Për fitimin e statusit “Shkollë me status të veçantë” zbatohet procedura, si më poshtë vijon:

a) IAPP-ja bën kërkesë me shkrim për fitimin e statusit “Shkollë me status të veçantë” pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;

b) Ministria përgjegjëse për arsimin, nëpërmjet institucionit përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor në arsimin parauniversitar, verifikon plotësimin e kriterëve, të përcaktuara në këtë vendim;

c) Ky institucion, pas verifikimit, jo më vonë se 3 (tre) muaj para fillimit të vitit shkollor, përcjell në ministrinë përgjegjëse për arsimin propozimin, raportin e vlerësimit për dhënien e statusit “Shkollë me status të veçantë”, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, bazuar në përmbushjen e kriterëve, të përcaktuara në këtë vendim;

ç) Ministri përgjegjës për arsimin miraton ose refuzon dhënien e statusit “Shkollë me status të veçantë” për IAPP-të.

5. IAPP-ja me status të veçantë humbet statusin e dhënë nga ministri përgjegjës për arsimin, nëse për 3 (tre) vjet radhazi nuk garanton përmbushjen e kriterëve për dhënien e statusit të veçantë, të përcaktuara në këtë vendim. Procedura e heqjes së statusit të veçantë është e njëjtë me atë të përcaktuar në shkronjat “b” e vijuese, të pikës 4, të këtij vendimi.

6. Struktura organizative, rregullorja e funksionimit të “Shkollës me status të veçantë” miratohet nga ministri përgjegjës për arsimin, me propozim nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor në arsimin parauniversitar.



7. Për lëndët e kulturës artistike/sportive IAPP-ja mund të kontraktojë me kohë të pjesshme specialistë/personalitate të fushës/disiplinave, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e funksionimit të shkollave me status të veçantë.

8. Kurrikula mësimore e “Shkollës me status të veçantë” dhe standardet profesionale të personelit, sipas profileve, hartohen nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar dhe miratohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.

9. Financimi i veprimtarisë së IAPP-ve, që fitojnë statusin “Shkollë me status të veçantë” realizohet me fonde publike, me burim financimi nga buxheti i shtetit, të ardhurat e njëjësive të vetëqeverisjes vendore, dhurimet e sponsorizimet, të ardhurat e përftuara nga vetë IAPP-ja, si dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

10. Financimi i veçantë nga buxheti i shtetit planifikohet me formulën “Për nxënës”, sipas treguesve të veçantë të niveleve arsimore dhe kushteve që do të sigurojnë IAPP-të “Shkollë me status të veçantë”.

11. Ministria përgjegjëse për financat dhe ministria përgjegjëse për arsimin miratojnë hapjen dhe mbylljen e llogarive buxhetore në degën vendore të thesarit apo llogari në bankat e nivelit të dytë, ku ka vendndodhjen institucioni arsimor publik me status të veçantë për të ardhurat e krijuara nga vetë institucioni. Rregullat e administrimit financiar për llogaritë buxhetore apo llogaritë në bankat e nivelit të dytë përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe të ministrit përgjegjës për financat.

12. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin.

13. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor në arsimin parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore arsimore parauniversitare dhe institucionet arsimore parauniversitare publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 150, datë 13.3.2024

PËR NGARKIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI AUTORITET KONTRAKTOR PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “KOLEGJI I EVROPËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese për realizimin e projektit “Kolegji i Evropës” dhe autoritet kontraktor për kryerjen e procedurave të prokurimit publik për hartimin e zbatimin e projektit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, duke lidhur edhe kontratat përkatëse, si dhe të ndjekë zbatimin e tyre e të projektit.

2. Në funksion të realizimit të projektit sipas pikës 1, Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në përputhje me kërkesat e Kolegjit të Evropës, dhe parashikimet e marrëveshjeve ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kolegjit të Evropës, harton programin e zhvillimit dhe ndjek detyrën e projektimit për realizimin e projektit “Kolegji i Evropës”, duke pasur parasysh parashikimet e vendimit nr. 641, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktor për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për projektet ‘Ndërtim i kampusit të ri të Universitetit të Tiranës’, ‘Ndërtim i godinave të Universitetit të Arteve të Tiranës’ dhe ‘Ndërtim i Korpusit të Policisë së Shtetit, Policisë Shkencore dhe Akademisë së Sigurisë’”.

3. Projekti zhvillohet në pasurinë (truall) me nr. 5/637, të ndodhur në qytetin e Tiranës, zona kadastrale nr. 8160, nr. faqe 48, nr. vol. 50, të vënë në dispozicion nga Bashkia e Tiranës, sipas vendimit nr. 16, datë 31.1.2024, të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë, “Për dhënie të pëlqimit në parim për zhvillimin e projektit ‘Kolegji i Evropës’, si pjesë



integrale e masterplanit të zhvillimit të zonës në pasurinë 5/637, të ndodhur në qytetin e Tiranës, zona kadastrale 8160, nr. faqe 48, nr. vol. 50, në pronësi të Bashkisë së Tiranës”, duke pasur parasysh procedurat e zhvilluara në kuadër të vendimit nr. 641, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktor për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për projektet ‘Ndërtim i kampusit të ri të Universitetit të Tiranës’, ‘Ndërtim i godinave të Universitetit të Arteve të Tiranës’ dhe ‘Ndërtim i korpusit të Policisë së Shtetit, Policisë Shkencore dhe Akademisë së Sigurisë’”.

4. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Bashkia Tiranë lidhin marrëveshje bashkëpunimi, në funksion të zhvillimit të projektit, sipas pikës 1 të këtij vendimi dhe parashikimeve të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kolegjit të Evropës.

5. Fondi Shqiptar i Zhvillimit i paraqet Ministrisë së Financave kërkesën për të hartuar e për të ndërmarrë nismën për alokimin e fondeve të nevojshme për zbatimin e projektit prej tij. Fondi për realizimin e projektit “Kolegji i Evropës” parashikohet në programin “Programe zhvillimi” të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 151, datë 13.3.2024

PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. THIMJO PLAKU

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 26, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor

për vitin 2024”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Thimjo Plaku, në masën 3 200 000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë.

2. Ky fond përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 153, datë 13.3.2024

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHËRBIMIT TË PROVËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 78/2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Klevis Qose, drejtor i përgjithshëm i Shërbimit të Provës, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Ermal Pacaj emërohet drejtor i përgjithshëm i Shërbimit të Provës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

**VENDIM****Nr. 154, datë 13.3.2024****PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM
TË BURGJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Klevis Qose emërohet drejtor i përgjithshëm i Burgjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR**Nr. 93, datë 13.3.2024****PËR DELEGIM TË PËRKOQSHËM TË
KOMPETENCAVE**

Në zbatim të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të VKM-së nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, nenit 26 të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të mëposhtme të titullarit të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial, z. Mark Ndreca.

2. Z. Mark Ndreca i delegohen kompetencat si më poshtë:

- ndjek dhe zbaton “Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, e ndryshuar;

- ndjek dhe monitoron prezencën në punë të personelit të AKSIK-së;

- ndjek detyrat e vendosura në planin mujor;

- merr dhe trajton korrespondencën shkresore.

3. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën nga data 18.3.2024 deri më 22.3.2024.

4. Z. Mark Ndreca nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial.

6. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

7. Ky urdhër hartohet në 3 (tri) kopje të njëjta, një për Protokoll-Arkivin, një për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe një për drejtorin e Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dorian Tola

VENDIM**Nr. 15, datë 6.3.2024****PËR NJË NDRYSHIM NË
RREGULLOREN “PËR RAPORTIN E
MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 58, shkronjat: “a”, “b”, “c” dhe “ç”, dhe të nenit 60, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, miratuar me vendimin



e Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.7.2013, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Në nenin 25, pika 3, shkronja “d”, pas togfjalëshit “*nëpërmjet filialeve, degëve ose agjencive të saj*”, shtohet togfjalëshi “*, me përjashtim të vlerës së kredisë së akorduar në Republikën e Kosovës*”.

2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

URDHËR
Nr. 27, datë 12.3.2024

PËR SHFUQIZIMIN E KOMPETENCAVE TË DELEGUARA

Në mbështetje të neneve 22, 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, në pamundësi të prezencës për një periudhë të pacaktuar kohe të znj. Alketa Çeli, me detyrë kancelar i institucionit, dhe me qëllim garantimin e vijueshmërisë normale të punës,

URDHËROJMË:

1. Shfuqizimin e kompetencave të deleguara me urdhrin e Komisionerëve Publikë nr. 47, datë 16.5.2022, “Për delegim kompetencash”, kancelarit të institucionit, znj. Alketa Çeli.

Ky urdhër hyn në fuqi në datën 12.3.2024 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERËT PUBLIKË
Florian Ballhysa, Irena Nino

URDHËR
Nr. 28, datë 12.3.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”; të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe të urdhrit të Komisionerëve Publikë nr. 27, datë 12.3.2024, “Për shfuqizimin e kompetencave të deleguara”,

URDHËROJMË:

1. Kompetencat e titullarit të Autoritetit Kontraktor, për procedurat e prokurimit në Institucionin e Komisionerëve Publikë, të kryhen nga z. Florian Ballhysa, Komisioner Publik.

2. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.

Ky urdhër hyn në fuqi në datën 12.3.2024 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERËT PUBLIKË
Florian Ballhysa, Irena Nino

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë

